

Türkiye İş Bankası A.Ş. – DEGA NË KOSOVË

PASQYRAT FINANCARE DHE RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR
MË DHE PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2023

PËRMBAJTJA

	Faqe
RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR	2-3
PASQYRAT FINANCIARE:	
PASQYRA E POZITËS FINANCIARE	4
PASQYRA E FITIMIT OSE HUMBJES DHE TË ARDHURAVE TË TJERA	
GJITHPËPËRFSHIRËSE	5
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË EKUITET	6
PASQYRA E RRJEDHËS SË PARASË	7
SHËNIMET E PASQYRAVE FINANCIARE	8– 55

RSM KOSOVO SH.P.K.Rr. Xhevdet Doda
Dukagjini Residence, Hyrja
B-C Lam B, Kati 2, no. 56
10 000 Prishtina
Republic of Kosovo

DL +383 45 666 888

www.rsm.global/kosovo

RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR

Për Aksionarët dhe Menaxhmentin e Türkiye İş Bankası A.Ş. – Dega në Kosovë

Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Türkiye İş Bankası A.Ş.— Dega në Kosovë ("Banka"), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më 31 Dhjetor 2023, pasqyrën e fitimit dhe humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në ekuitet dhe pasqyrën e rrjedhjes së parasë për vitin e përfunduar, si dhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë politikat materiale kontabël.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare shoqëruese paraqesin drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozitën financiare të Bankës më 31 Dhjetor 2023, si dhe performancën e saj financiare dhe rrjedhën e parasë për vitin e përfunduar në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Baza për Opinion

Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve përshkruhen në mënyrë më të detajuar në paragrafin 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare' në këtë raport. Ne jemi të pavarur nga Banka në përputhje me Kodin Ndërkombëtar të Etikës për Kontabilistët Profesionistë të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Kontabilistët (përfshirë Standardet Ndërkombëtare të Pavarësisë) (Kodi BSNEK), dhe me kërkesat etike që janë relevante për auditimin e pasqyrave financiare në Republikën e Kosovës, dhe kemi përbushur përgjegjësitë tona të tjera etike në përputhje me këto kërkesa dhe Kodin BSNEK. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi marrë është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të ofruar një bazë për opinionin tonë.

Çështje tjera

Pasqyrat financiare të Bankës për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2022 janë audituar nga një auditor tjetër që ka lëshuar një opinion të pamodifikuar më 3 prill 2023.

Informatat tjera

Menaxhmenti është përgjegjës për informata tjera. Informatat tjera përbëjnë informatat e përfshira në raportin vjetor të Bankës, por nuk përfshijnë pasqyrat financiare dhe raportin tonë të auditorit. Raporti vjetor i Bankës pritet të na vihet në dispozicion pas datës së raportit të auditorit. Opinionin ynë për pasqyrat financiare nuk mbulon informatat tjera dhe ne nuk shprehim asnjë konkluzion mbi të.

Në lidhje me auditimin tonë të pasqyrave financiare, përgjegjësia jonë është ti lexojmë informatat tjera të identifikuar më lartë kur të bëhet i disponueshëm, dhe duke vepruar kështu, të konsiderojmë nëse informatat tjera janë materialisht në kundërshtim me pasqyrat financiare ose njohuritë tona të marra në auditim, ose në të kundërt duket se është materialisht i keqdeklaruar. Kur lexojmë raportin vjetor, nëse konkludojmë se ka një keqdeklarim material në të, neve na kërkohet që t'ua komunikojmë çështjen atyre që janë të ngarkuar me qeverisjen dhe të raportojmë mospajtueshmërinë.

THE POWER OF BEING UNDERSTOOD**AUDIT | TAX | CONSULTING**

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe Personave të Ngarkuar me Qeverisjen për Pasqyrat Financiare

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar dhe për ato kontrole të brendshme të cilat menaxhmenti i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, menaxhmenti është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Bankës për të vazhduar aktivitetin, duke i shpalosur, kur është e aplikueshme, çështjet në lidhje me vazhdimin e aktivitetit dhe përdorimin e kontabilitetit me parim të vijimësisë përveç nëse menaxhmenti synon ta likujdojë Bankën ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç se ta bëjë këtë.

Personat e ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Bankës.

Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë të marrim siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimeve apo gabimeve, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk është një garancion që një auditim i kryer në përputhje me SNA-të gjithmonë do të zbulojë anomali materiale kur ato ekzistojnë. Anomali mund të vijë si rezultat i gabimeve ose mashtrimeve dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose në tërësi, pritet që në mënyrë të arsyeshme të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticizmin profesional gjatë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimeve apo gabimeve, dizajnojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit në përgjigje të këtyre rreziqeve, dhe sigurojmë evidencë të auditimit të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të një anomalie materiale që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa rreziku që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, lëshime të qëllimshme, keqinterpretime apo shkelje të kontroleve të brendshme.
- Marrim një kuptim të kontrollit të brendshëm të përshtatshëm për auditim me qëllim të dizajnit të procedurave të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat, por jo për qëllimin e shprehjes së një opinion mbi efektivitetin e kontroleve të brendshme të Bankës.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e përlogaritjeve kontabël dhe shpalosjeve përkatëse të bëra nga menaxhmenti.
- Nxjerrim një përfundim lidhur me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës së kontabilitetit mbi parimin e vijimësisë nga menaxhmenti, në bazë të evidencave të auditimit të siguruar, nëse ekziston një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet që mund të hedhin dyshime domethënëse mbi parimin e vijimësisë të Bankës. Nëse arrijmë në përfundim se ekziston një pasiguri materiale, ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditorit për shpalosjet përkatëse në pasqyrat financiare ose nëse këto shpalosje janë të papërshtatshme, të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona të auditimit bazohen në evidencat e auditimit të siguruar deri në datën e raportit tonë të auditimit. Megjithatë, ngjarje ose kushte në të ardhmen mund të ndikojnë që Banka të ndërpres veprimtarinë.
- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, duke përfshirë informacionet shpjeguese të dhëna, dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet e ndodhura në mënyrë që të arrijnë një paraqitje të drejtë.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar për qeverisjen, përveçse çështjeve të tjera, edhe fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit, gjetjet kryesore të auditimit, përfshirë çdo mangësi relevante në kontrollin e brendshëm të identifikuar gjatë auditimit tonë.

RSM Kosovo Sh.p.k.

RSM Kosovo Sh.p.k.

Prishtinë, Republika e Kosovës

28 Shkurt 2024



Sadik Berisha

Auditor Ligjor

Türkiye İş Bankası A.Ş.- DEGA NË KOSOVË
PASQYRAT FINANCIARE

Pasqyra e pozitës financiare më 31 dhjetor 2023
(Shumat në Euro)

		31 dhjetor 2023	31 dhjetor 2022
	Notes		
Pasuritë			
Paratë në dorë dhe në banka dhe gjendja me Bankën Qendrore	7	8,489,294	28,232,293
Investimet në letra me vlerë	8	7,037,802	99,770
Depozitat me afat të caktuar në banka	9	1,242,791	-
Kreditë dhe paradhëniet për klientët	10	101,970,836	93,045,345
Prona dhe pajisjet	11	321,663	413,448
Pasuritë e paprekshme	12	173,128	227,045
E drejta e përdorimit të pasurisë së marrë me qira	13	980,376	1,240,900
Kolateralet e riposeduara	14	2,985	303,872
Parapagimi i tatimit në fitim	15	132,269	97,024
Pasuritë tjera	16	55,295	40,084
Pasuria tatimore e shtyrë	29	-	2,148
Gjithsej pasuritë		120,406,439	123,701,929
Detyrimet			
Detyrimet ndaj klientëve	17	83,936,801	90,414,411
Detyrimet ndaj bankave dhe Zyrës Qendrore	18	22,213,281	19,995,639
Tatimi në të ardhura të korporatës	29	-	167,071
Detyrimet tjera	19	481,642	549,173
Detyrimet e qirasë	20	1,148,540	1,403,580
Detyrimi tatimor i shtyrë	29	26,875	-
Gjithsej detyrimet		107,807,139	112,529,874
Kapitali aksionar			
Kapitali aksionar	21	10,000,000	10,000,000
Fitimi i akumuluar		2,599,300	1,172,055
Gjithsej kapitali aksionar		12,599,300	11,172,055
Gjithsej detyrimet dhe kapitali aksionar		120,406,439	123,701,929

Këto Pasqyra Financiare janë miratuar nga Menaxhmenti i Bankës më 23 shkurt 2024 dhe janë nënshkruar në emër të tyre nga:



Onur Kütük

Drejtor Ekzekutiv

Türkiye İş Bankası A.Ş.
Dega në Kosovë



Fatbardha Uruqi Mustafa

Zëvendës Kryeshefe Ekzekutive
Zyrtare Kryesore Financiare
Türkiye İş Bankası A.Ş.
Dega në Kosovë

Shënimet shoqëruese 1 deri në 32 përbëjnë një pjesë integrale të këtyre pasqyrave financiare.

Türkiye İş Bankası A.Ş.- DEGA NË KOSOVË
PASQYRAT FINANCIARE

Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave tjera gjithëpërfshirëse për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2023 (Shumat në Euro)

		Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2023	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2022
	Shenime		
Të hyrat nga interesi	22	6,154,674	5,546,586
Shpenzimet e interesit	22	(2,718,406)	(1,986,203)
Të hyrat neto nga interesi	22	3,436,268	3,560,383
Të hyrat nga tarifat dhe komisionet	23	301,762	224,613
Shpenzimet e tarifave dhe të komisioneve	23	(23,732)	(58,894)
Të hyra neto nga tarifat dhe komisionet	23	278,030	165,719
(Humbja)/Fitimi neto nga këmbimi valutor	24	(13,906)	81,864
Të hyrat tjera	25	87,079	130
Gjithsej të hyrave operative		73,173	81,994
Lirimi/(Shpenzimi) i humbjeve kreditore për kreditë dhe paradhëniet për klientët	26	59,442	(275,478)
Lirimi i humbjeve kreditore për instrumentet financiare dhe të tjera	26	88,215	5,399
Kthimi/(Shpenzimi) i rënies në vlerës të pasurive të riposeduara	14	134,780	(338,461)
Shpenzimet e tjera operative	27	(1,036,982)	(908,854)
Përfitimet e punonjësve	28	(1,012,719)	(779,344)
	11,12 dhe		
Shpenzimet e zhvlerësimit dhe amortizimit	13	(477,372)	(421,365)
Gjithsej shpenzimet		(2,527,073)	(2,109,563)
Fitimi para tatimit		1,542,835	1,089,993
Tatimi në fitim	29	(115,590)	(222,869)
Fitimi neto për vitin		1,427,245	867,123
Të hyra tjera gjithëpërfshirëse		-	-
Gjithsej fitimi gjithëpërfshirës për vitin		1,427,245	867,123

Shënimet shoqëruese 1 deri në 32 përbëjnë një pjesë integrale të këtyre pasqyrave financiare.

Türkiye İş Bankası A.Ş.- DEGA NË KOSOVË
PASQYRAT FINANCIARE

Pasqyra e ndryshimeve në kapital për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2023
(Shumat në Euro)

	Kapitali aksionar	Fitimi i akumuluar	Gjithsej kapitali aksionar
Gjendja më 1 janar 2022	10,000,000	2,457,442	12,457,442
Fitimi neto për vitin	-	867,123	867,123
Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse	-	-	-
Gjithsej të ardhurat gjithëpërfshirëse për vitin	-	867,123	867,123
Transaksionet me pronarët, të njohura direkt në ekuitet			
Shpërndarjet për pronarët/dividend	-	(2,152,510)	(2,152,510)
Gjendja më 31 dhjetor 2022	10,000,000	1,172,055	11,172,055
Fitimi neto për vitin	-	1,427,245	1,427,245
Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse	-	-	-
Gjithsej të ardhurat gjithëpërfshirëse për vitin	-	1,427,245	1,427,245
Transaksionet me pronarët, të njohura direkt në ekuitet			
Shpërndarjet për pronarët/dividend	-	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2023	10,000,000	2,599,300	12,599,300

Shënimet shoqëruese 1 deri në 32 përbëjnë një pjesë integrale të këtyre pasqyrave financiare.

Türkiye İş Bankası A.Ş.- DEGA NË KOSOVË
PASQYRAT FINANCIARE

Pasqyra e rrjedhës së parasë për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2023
(Shumat në Euro)

		Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2023	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2022
	Shenime		
I. Rrjedha e parasë nga aktivitetet operative			
Fitimi para tatimit		1,542,835	1,089,993
Rregullimet për:			
Depreciation and amortization	11,12 dhe 13	477,372	421,365
(Fitimi)/Shpenzimi nga rënia në vlerë, neto	26	(147,657)	270,080
Fitimi neto nga shitja e aseteve		(181,021)	-
Të hyrat nga interesi	22	(6,154,674)	(5,546,586)
Shpenzimet e interesit	22	2,718,406	1,986,203
Kthimi/(Shpenzimi) i rënies në vlerës të pasurive të riposeduara	14	(134,780)	338,461
Ndryshimet në pasuritë dhe detyrimet operative:			
Lëvizjet në rezervat e detyrueshme me BQK-në	7	6,489,506	(1,355,791)
Rritja në depozitat me banka	9	(1,248,869)	-
(Rritja)/Zvogëlimi në huatë dhe paradhëniet për klientët	10	(8,088,059)	3,416,276
(Zvogëlimi)/ Rritja e detyrimeve ndaj klienteve	17	(6,355,860)	4,212,256
Rritja në detyrimet tatimore dhe detyrimet tjera	19	10,329	88,930
Rritja në avanset dhe të arkëtueshmet tjera	16	(15,239)	(13,651)
Tatimi në fitim i paguar	29	(288,939)	(31,402)
Interesi i paguar	22	(2,779,007)	(1,687,766)
Interesi i arkëtuar	22	5,951,734	5,450,967
Paraja neto (e përdorur në)/ gjeneruar nga aktivitetet operative (I)		(8,203,923)	8,639,334
II. Rrjedha e parasë nga aktivitetet investuese			
Blerjet e pronës dhe pajisjeve	11	(57,678)	(15,655)
Blerjet e pasurive të paprekshme	12	(13,467)	(51,817)
(Investimet)/ Tërheqjet në letrat me vlerë	8	(6,900,000)	1,250,000
Paraja neto (e përdorur në)/ gjeneruar nga/aktivitetet investuese (II)		(6,971,145)	1,182,528
III. Rrjedha e parasë nga aktivitetet financuese			
Rritjet e/(Ripagimi i) huamarrjeve nga bankat dhe Zyra Qendrore	18	2,250,217	(3,982,500)
Dividenda e paguar		-	(2,152,511)
Pagesat e qirasë	13	(348,765)	(356,625)
Paraja neto nga/(e përdorur në) aktivitetet financuese (III)		1,901,452	(6,491,636)
IV. (Zvogëlimi)/Rritja neto në para dhe ekuivalentët e saj (I+II+III)		(13,273,616)	3,330,227
V. Paraja dhe ekuivalentët e saj në fillim të vitit		14,363,482	11,033,255
VI. Paraja dhe ekuivalentët e saj në fund të vitit (IV + V)	7	1,089,866	14,363,482

Shënimet shoqëruese 1 deri në 32 përbëjnë një pjesë integrale të këtyre pasqyrave financiare.

Türkiye İş Bankası A.Ş.- DEGA NË KOSOVË

PASQYRAT FINANCIARE

*Shënimet e pasqyrave financiare më dhe për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2023
(Shumat në Euro, përveç nëse është specifikuar ndryshe)*

1. ENTITETI RAPORTUES

Türkiye İş Bankası A.Ş. – Dega në Kosovë (“Banka” ose “Dega”) është një degë e Türkiye İş Bankası A.Ş., një entitet turk.

Banka operon si bankë komerciale dhe e kursimeve për të gjitha kategoritë e klientëve brenda Kosovës.

Banka operon nën licencën bankare Nr. 011 të lëshuar nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës. Dega është regjistruar në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë me 19 nëntor 2012 dhe ka numër biznesi 810821456. Banka operon me dy degë. Një zyrë gjendet tek rr. Ukshin Hoti, 100 në Prishtinë ndërsa tjetra në Prizren, rruga Zahir Pajaziti.

Banka kishte 34 të punësuar më 31 dhjetor 2023 (31 të punësuar më 31 dhjetor 2022).

2. BAZAT E PËRGATITJES

(a) Deklarata e pajtueshmërisë

Këto pasqyra financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) dhe interpretimet e tyre të miratuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (BSNK).

(b) Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

(c) Paraqitja e pasqyrave dhe shënimeve financiare

Për qëllime të qartësisë, pasqyrat financiare dhe shënimet e pasqyrave financiare janë përgatitur duke përdorur konceptet e materialitetit dhe relevancës. Kjo do të thotë që zërat që nuk konsiderohen materiale për sa i përket matjeve sasiore dhe cilësore ose të lidhura me përdoruesit e pasqyrave financiare, grumbullohen dhe paraqiten së bashku me zërat e tjerë në pasqyrat financiare primare. Në mënyrë të ngjashme, informacioni që nuk konsiderohet material nuk është paraqitur në shënime. Banka ka vetëm një segment biznesi dhe për këtë arsye raportimi i segmentit të veçantë i përshkruar në SNRF 8 nuk është paraqitur.

(d) Parimi i vijimësisë

Në vlerësimin e parimit të vijimësisë së Bankës më 31 dhjetor 2023, Drejtorët kanë marrë në konsideratë një gamë të gjerë informacioni në lidhje me kushtet aktuale dhe të ardhshme, duke përfshirë pozicionin aktual financiar të Bankës dhe parashikimet e ardhshme të përfitimit, rrjedhjen e parave, burimeve dhe kërkesave të kapitalit, të cilat të gjitha përfshihen në planin e saj të biznesit.

Projeksionet e parashikimit të rasteve bazë bazohen në planifikimin e detajuar financiar nga menaxhmenti që merr parasysh mjedisin aktual dhe të pritshëm ekonomik. Drejtorët gjithashtu morën parasysh ndikimin e risqeve kyçe ekzistuese dhe risqeve në ngritje në modelin dhe planin e biznesit të Bankës.

Drejtorët kanë vlerësuar perspektivën e Bankës për një periudhë më të gjatë se 12 muajt nga nënshkrimi i këtyre pasqyrave financiare siç kërkohet nga Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit. Drejtorët kanë shqyrtuar gjithashtu ndikimin financiar dhe kapital të një sërë stresesh të rënda por të besueshme kapitale dhe të likuiditetit në planin e biznesit në rastin bazë. Këto strese bazohen në Rregulloren e BQK-së për “Menaxhimin e Rrezikut Kreditor”, Rregulloren e BQK-së për “Menaxhimin e Rrezikut të Likuiditetit”, “Procedurën e Brendshme për Testin e stresit të kredisë” dhe “Procedurën e brendshme për Testin e stresit të likuiditetit”.

Është vlerësuar gjithashtu ndikimi i veprimeve të menaxhmentit që mund të ndërmerren për të zbutur ndikimin e këtyre stresëve. Pas veprimeve të menaxhmentit, parashikimet nën këto skenarë stresi tregojnë se Banka do të jetë në gjendje të operojë në nivele të mjaftueshme të kapitalit dhe likuiditetit (në tejkalim të kërkesave të BQK-së) dhe do të përmbushë detyrimet e saj të ardhshme për të paktën 12 muajt nga nënshkrimi i këtyre pasqyrave financiare.

Pas rishikimit të projeksioneve dhe bërjes së pyetjeve të hollësishme, Drejtorët vlerësojnë që Banka ka kapital, likuiditet dhe burime të mjaftueshme për të vazhduar për të paktën 12 muajt nga nënshkrimi i këtyre pasqyrave financiare dhe ka kapital të mjaftueshëm për të përmbushur kërkesat e saj regulatorike siç janë parashikuar nga rregullat dhe procedurat e brendshme të vendosura më sipër.

Për rrjedhojë, baza e kontabilitetit në vazhdimësi është adoptuar për përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare.

2. BAZAT E PËRGATITJES (VAZHDIM)

(e) Valuta funksionale dhe e prezentimit

Pasqyrat financiare janë prezentuar në EUR, që është edhe valuta funksionale e bankës.

(f) Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve

Përgatitja e pasqyrave financiare konform parimeve të SNRF kërkon nga menaxhmenti të bëjë gjykime, vlerësime dhe supozime të cilat ndikojnë në zbatimin e politikave dhe shumave të raportuara të pasurive, detyrimeve, të hyrave dhe shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë si rezultat i këtyre vlerësimeve. Vlerësimet dhe supozimet bazë rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve njihen në mënyrë prospektive.

Gjykimet

Informacioni në lidhje me gjykimet e bëra në zbatimin e politikave kontabël që kanë ndikimin më të rëndësishëm në shumat e njohura në pasqyrat financiare përfshihen në shënimet e mëposhtme:

- Shënimet 3(f): Klasifikimi i instrumenteve financiare: vlerësimi i modelit të biznesit brenda të cilit mbahen pasuritë dhe vlerësimi nëse kushtet kontraktuale të asetit financiar janë VPPI për shumën kryesore të papaguar.

- Shënimet 3(g): Vendosja e kriterëve për përcaktimin nëse rreziku kreditor në asetin financiar është rritur në mënyrë të konsiderueshme që nga njohja fillestare, përcaktimi i metodologjisë për përfshirjen e informacionit të ardhshëm në vlerësimin e HPK dhe përzgjedhjen dhe miratimin e modeleve të përdorura për të matur HPK.

Supozimet dhe pasiguritë e vlerësimit

Informacioni në lidhje me supozimet dhe pasiguritë e vlerësimit në datën e raportimit që kanë një rrezik të konsiderueshëm për të rezultuar në një rregullim material të vlerës kontabël të aseteve dhe detyrimeve brenda vitit të ardhshëm financiar përfshihet në shënimet e mëposhtme:

Shënim 3(g): Zhvlerësimi i instrumenteve financiare: përcaktimi i inputit në modelin e matjes HPK, duke përfshirë supozimet kryesore të përdorura në vlerësimin e rrjedhës së parave të rikuperueshme dhe përfshirjen e informacionit të ardhshëm.

Shënim 3e: Vlerësimi i normës rritëse të huamarrjes për një qira.

Shënim 5: Matja e vlerës së drejtë të instrumenteve financiare me inpute të rëndësishme të pavëzhgueshme.

Türkiye İş Bankası A.Ş.- DEGA NË KOSOVË

PASQYRAT FINANCIARE

Shënimet e pasqyrave financiare më dhe për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2023
(Shumat në Euro, përveç nëse është specifikuar ndryshe)

3. POLITIKAT MATERIALE KONTABËL

Banka ka zbatuar vazhdimisht politikat kontabël të mëposhtme për të gjitha periudhat e paraqitura në këto pasqyra financiare, përveç nëse përmendet ndryshe. Për më tepër, Banka miratoi Shpalosjen e politikave të kontabilitetit (Amendamentet në SNK 1 dhe Deklarata e Praktikës SNRF 2) nga 1 janari 2023. Amendamentet kërkojnë dhënien e informacioneve shpjeguese të politikave kontabël 'materiale', në vend të 'të rëndësishmeve'. Megjithëse ndryshimet nuk rezultuan në ndonjë ndryshim në vetë politikat kontabël, ato ndikuan në informacionin e politikave kontabël në lidhje me instrumentet financiare të shpalosura në shënimin 3 në raste të caktuara (shih shënimin 4(i) për informacion të mëtejshëm).

(a) Transaksionet në valutë të huaj

Transaksionet në valutë të huaj përkthehen në valutën funksionale sipas normave të këmbimit të datës së transaksionit. Pasuritë dhe detyrimet monetare të denominuara në valuta të huaja në datën e raportimit ripërkthehen në valutën funksionale sipas normës së këmbimit në atë datë. Pasuritë dhe detyrimet jomonetare të denominuara në valuta të huaja të cilat maten sipas vlerës së drejtë, përkthehen në valutën funksionale sipas normës së këmbimit në datën në të cilën është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat nga valuta e huaj që dalin nga ripërkthimi njihen si fitim ose humbje.

(b) Të hyrat dhe shpenzimet e interesit

Të hyrat dhe shpenzimet nga interesi që rrjedhin nga instrumentet financiare me interes të matura me kosto të amortizimit njihen në fitim ose humbje duke përdorur metodën efektive të interesit.

Në kalkulimin e normës efektive të interesit, Banka vlerëson rrjedhën e ardhshme të parasë duke konsideruar të gjitha kushtet kontraktuale të instrumenteve financiare, por jo edhe humbjet e ardhshme kreditore. Për aktivet financiare të dëmtuara nga kredia, një normë interesi efektive e rregulluar e kredisë llogaritet duke përdorur flukset e vlerësuara të parasë së ardhshme, përfshirë humbjet e pritura të kredisë.

Llogaritja e normës efektive të interesit përfshin të gjitha kostot e transaksionit, tarifat e pranuar ose paguara të cilat janë pjesë integrale e normës efektive të interesit. Kostot e transaksionit janë kosto rritëse që i atribuohen direkt blerjes, lëshimit ose heqjes nga përdorimi të një pasurie ose detyrimi financiar.

Në llogaritjen e të ardhurave dhe shpenzimeve nga interesi, norma efektive e interesit zbatohet në vlerën kontabël bruto të aktivit (kur aktivi nuk është i zhvlerësuar nga kredia) ose në koston e amortizuar të pasivit. Llogaritja e të ardhurave nga interesi nuk kthehet në bazë bruto, edhe nëse rreziku i kredisë i aktivit përmirësohet.

(c) Tarifat dhe komisionet

Të ardhurat dhe shpenzimet nga tarifat dhe komisionet që janë pjesë përbërëse e normës efektive të interesit për një pasuri ose detyrim financiar përfshihen në matjen e normës efektive të interesit.

Sipas SNRF 15, Banka njeh të ardhurat nga tarifat dhe komisionet nga një gamë e ndryshme shërbimesh financiare që u ofron klientëve të saj. Të ardhurat nga tarifat dhe komisionet njihen në një shumë që pasqyron shumën për të cilën Banka pret të ketë të drejtë në këmbim të ofrimit të shërbimeve dhe përgjithësisht njihen në një moment kohor kur transaksioni ndodh dhe Banka përmbush detyrimet e performancës.

Për kontratat që mbulojnë shumë vite, detyrimet e ekzekutimit, si dhe koha e përmbushjes së tyre, identifikohen dhe përcaktohen në fillim të kontratës. Më pas tarifat dhe komisionet njihen me kalimin e kohës kur dhe kur janë përmbushur detyrimet e performancës.

Banka në përgjithësi ka arritur në përfundimin se ajo është kryesore në marrëveshjet e saj të të ardhurave, sepse ajo zakonisht kontrollon shërbimet përpara se t'i transferojë ato te klienti.

3. POLITIKAT MATERIALE KONTABËL (VAZHDIM)

(d) Shpenzimet e tatimit në të ardhura

Shpenzimet e tatimit në të ardhura përbëhen nga tatimet afatshkurtra dhe tatimi i shtyrë. Shpenzimet e tatimit në të ardhura njihen në fitim ose humbje deri në masën që një zë njihet direkt në kapital ose në të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse.

Tatimi aktual

Tatimi aktual përbëhet nga tatimi që pritet të jetë i pagueshëm apo i arkëtueshëm në të ardhurat ose humbjet e tatueshme të vitit dhe çfarëdo rregullimi të tatimit të pagueshëm apo të arkëtueshëm nga vitet e kaluara. Llogaritet në bazë të normave tatimore në fuqi ose që kanë hyrë në fuqi në datën e raportimit.

Tatimi i shtyrë

Tatimi i shtyrë njihet duke llogaritur diferencat e përkohshme në mes të vlerave bartëse të pasurive dhe detyrimeve për qëllim të raportimit financiar dhe shumave të përdorura për qëllime të tatimit.

Tatimi i shtyrë duhet të matet sipas normave të tatimit që pritet të zbatohen në diferencat e përkohshme kur të kthehen, bazuar në ligjet në fuqi ose që kanë hyrë në fuqi në datën e raportimit.

Tatimi i shtyrë njihet si pasuri e vetme deri në atë masë që në të ardhmen do të ketë fitime të mundshme të tatueshme në dispozicion kundrejt të cilës mund të shfrytëzohen diferencat e përkohshme.

Pasuritë tatimore të shtyra dhe detyrimet tatimore të shtyra rishikohen në çdo datë raportimi dhe zvogëlohen në masën që nuk është më e mundshme që përfitimi tatimor përkatës dhe detyrimi tatimor përkatës do të realizohen. Taksat shtesë mbi të ardhurat që rrjedhin nga shpërndarja e dividendëve njihen në të njëjtën kohë kur njihet detyrimi për të paguar dividendin përkatës.

Banka kompenzon aktivet e saj tatimore të shtyra kundrejt detyrimeve vetëm kur ekziston një e drejtë ligjore për të kompensuar aktivet dhe detyrimet e saj aktuale tatimore dhe është qëllimi i Bankës për të shlyer mbi bazën neto.

(e) Qiratë

Banka si qiramarrëse

Banka vlerëson nëse një kontratë është ose përmban një qira, në fillimin e kontratës. Banka njeh një pasuri të së drejtës së përdorimit dhe një detyrim korrespondues të qirasë në lidhje me të gjitha marrëveshjet e qirasë në të cilat është qiramarrësi, me përjashtim të qirave afatshkurtra (të përcaktuara si qira me një afat qiraje prej 12 muajsh ose më pak) dhe qirave të aseteve me vlerë të ulët. Për këto qira, Banka njeh pagesat e qirasë si një shpenzim operativ mbi bazën lineare gjatë kohëzgjatjes së qirasë.

Detyrimi i qirasë

Detyrimi i qirasë matet fillimisht me vlerën aktuale të pagesave të qirasë që nuk janë paguar në datën e fillimit, të skontuar duke përdorur normën e nënkuptuar në qira. Nëse kjo normë nuk mund të përcaktohet lehtësisht, qiramarrësi përdor normën e tij shtesë të huamarrjes.

Pagesat e qirasë të përfshira në matjen e detyrimit të qirasë përfshijnë:

- Pagesat fikse të qirasë (përfshirë pagesat fikse në thelb), minus çdo stimul qiraje të arkëtueshme;
- Pagesat e ndryshueshme të qirasë që varen nga një indeks ose normë, e matur fillimisht duke përdorur indeksin ose normën në datën e fillimit;
- Shuma që pritet të paguhet nga qiramarrësi nën garancitë e vlerës së mbetur;
- Çmimin e ushtrimit të opsioneve të blerjes, nëse qiramarrësi është në mënyrë të arsyeshme i sigurt për ushtrimin e opsioneve; dhe
- Pagesat e gjobave për përfundimin e qirasë, nëse afati i qirasë pasqyron ushtrimin e një opsioni për të përfunduar qiranë.

Detyrimi i qirasë paraqitet si rresht i veçantë në pasqyrën e pozicionit financiar. Detyrimi i qirasë matet më pas duke rritur vlerën kontabël për të reflektuar interesin mbi detyrimin e qirasë (duke përdorur metodën e interesit efektiv) dhe duke reduktuar vlerën kontabël për të pasqyruar pagesat e qirasë të bëra. Banka rimat detyrimin e qirasë (dhe bën një rregullim përkatës në pasurinë përkatëse me të drejtën e përdorimit) sa herë që:

Türkiye İş Bankası A.Ş.- DEGA NË KOSOVË

PASQYRAT FINANCIARE

Shënimet e pasqyrave financiare më dhe për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2023
(Shumat në Euro, përveç nëse është specifikuar ndryshe)

3. POLITIKAT E MATERIALE KONTABËL (VAZHDIM)

e) Qiratë (vazhdim)

Detyrimi i qirasë (vazhdim)

- Afati i qirasë ka ndryshuar ose ka një ngjarje të rëndësishme apo ndryshim në rrethana që rezultojnë në një ndryshim në vlerësimin e ushtrimit të opsionit të blerjes, në këtë rast detyrimi i qirasë ri-matet duke zbritur pagesat e rishikuara të qirasë duke përdorur një normë të rishikuar diskontimi.
- Pagesat e qirasë ndryshojnë për shkak të ndryshimeve në një indeks ose normë ose një ndryshim në pagesën e pritshme nën një vlerë të mbetur të garantuar, në të cilat raste detyrimi i qirasë rimatet duke zbritur pagesat e rishikuara të qirasë duke përdorur një normë të pandryshuar diskontimi (përveç nëse pagesat e qirasë ndryshojnë për shkak të një ndryshimi në një normë interesi të ndryshueshme, në këtë rast përdoret një normë e rishikuar e diskontimit).
- Një kontratë qiraje është modifikuar dhe modifikimi i qirasë nuk llogaritet si një qira e veçantë, në këtë rast detyrimi i qirasë rimatet bazuar në afatin e qirasë së qirasë së modifikuar duke zbritur pagesat e rishikuara të qirasë duke përdorur një normë të rishikuar diskontimi në datën e modifikimit.

E drejta e përdorimit të aseteve

- E drejta e përdorimit të pasurisë përfshinë matjen fillestare të detyrimit përkatës të qirasë, pagesat e qirasë të bëra në ose para ditës së fillimit, të zbritura për çdo shumë të japur si stimuj për të marrë/dhënë qiranë dhe çdo kosto fillestare direkte. Ato më pas maten me kosto, të zbritur për zhvlerësim të akumuluar dhe humbje nga zhvlerësimi.
- E drejta e përdorimit të pasurisë zhvlerësohet gjatë periudhës më të shkurtër të afatit të qirasë dhe jetës së dobishme të pasurisë. Zhvlerësimi fillon në datën e fillimit të qirasë.
- E drejta e përdorimit të pasurisë paraqitet si një linjë e veçantë në pasqyrën e pozicionit financiar.

Qiratë e ndryshueshme që nuk varen nga një indeks ose normë nuk përfshihen në matjen e detyrimit të qirasë dhe të aktivitetit të së drejtës së përdorimit. Pagesat e lidhura njihen si shpenzim në periudhën në të cilën ndodh ngjarja ose gjendja që shkakton këto pagesa.

(f) Instrumentet financiare

Pasuritë financiare dhe detyrimet financiare njihen në pasqyrën e pozicionit financiar të Bankës kur Banka bëhet palë në dispozitat kontraktuale të instrumentit ose në datën në të cilën ato janë krijuar.

Pasuritë financiare dhe detyrimet financiare maten fillimisht me vlerën e drejtë. Kostot e transaksionit që i atribuohen drejtpërdrejt blerjes ose emetimit të aktiveve dhe detyrimeve financiare (përveç aktiveve financiare dhe detyrimeve financiare me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes) i shtohen ose zbriten nga vlera e drejtë e aktiveve ose detyrimeve financiare. sipas rastit, në njohjen fillestare. Kostot e transaksionit që i atribuohen drejtpërdrejt blerjes së aktiveve financiare ose detyrimeve financiare me vlerën e drejtë përmes fitimit ose humbjes njihen menjëherë në fitim ose humbje.

Të gjitha blerjet ose shitjet në mënyrë të rregullt të pasurive financiare njihen dhe çregjistrohen në bazë të datës së tregtisë. Blerjet ose shitjet në mënyrë të rregullt janë blerje ose shitje të pasurive financiare që kërkojnë shpërndarjen e pasurive brenda afatit kohor të përcaktuar me rregullore ose konventë në treg.

Asartet dhe detyrimet financiare kompensohen dhe shuma neto raportohet në bilanc vetëm nëse ekziston një e drejtë e zbatueshme ligjrisht për të kompensuar shumat e njohura dhe ka një qëllim për t'u shlyer në bazë neto.

Klasifikimi dhe vlerësimi i aseteve financiare dhe detyrave financiare

Nën IFRS 9, asetet financiare klasifikohen në bazë të modelit të biznesit të adoptuar për menaxhimin e aseteve dhe karakteristikat e tyre kontraktuale të rrjedhjes së parasë në njërin nga kategoritë e vlerësimit vijuese:

- Kosto e amortizuar (AMC)
- Vlerë e drejtë përmes të ardhurave të tjera të përgjithshme (FVOCI)
- Vlerë e drejtë përmes fitimit ose humbjes (FVPL)

Asetet financiare maten në AMC nëse mbahen brenda një modeli biznesi për qëllime të mbledhjes së rrjedhjeve kontraktuale të parave (mbahen për të mbledhur) dhe nëse rrjedhjet e parave janë vetëm pagesa të principalit dhe interesit mbi shumën e paguar të principalit. Në përgjithësi, kjo është rasti për portofolin e aseteve financiare të Bankës.

Banka nuk ka asete financiare që maten në FVOCI dhe / ose FVPL.

Türkiye İş Bankası A.Ş.- DEGA NË KOSOVË PASQYRAT FINANCIARE

*Shënimet e pasqyrave financiare më dhe për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2023
(Shumat në Euro, përveç nëse është specifikuar ndryshe)*

3. POLITIKAT MATERIALE KONTABËL (VAZHDIM)

(f) Instrumentet financiare (vazhdim)

Në përgjithësi, detyrimet financiare maten me kosto të amortizuar.

(i) Fitimet dhe humbjet nga këmbimi valutor

Vlera kontabël e aseteve dhe detyrimeve financiare që janë të shprehura në një monedhë të huaj përcaktohet në atë monedhë të huaj dhe përkthehet me kursin spot në fund të çdo periudhe raportuese. Në mënyrë të veçantë, për assetet dhe detyrimet financiare të matura me koston e amortizuar që nuk janë pjesë e një marrëdhënieje të caktuar mbrojtëse, diferencat e këmbimit njihen në fitim ose humbje në zërin "fitime dhe humbje të tjera".

(ii) Çregjistrimi i pasurive financiare

Banka çregjistron një pasuri financiare vetëm kur skadojnë të drejtat kontraktuale të fluksit të parave nga pasuria, ose kur transferon pasurinë financiare dhe në thelb të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë së pasurisë në një entitet tjetër. Nëse Banka nuk transferon dhe nuk mban në masë të madhe të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë dhe vazhdon të kontrollojë pasurinë e transferuar, Banka njih interesin e saj të mbajtur një pasuri dhe një detyrim shoqërues për shumat që mund të duhet të paguajë.

Për çregjistrimin e një pasurie financiare të matur me koston e amortizuar, diferenca midis vlerës kontabël të pasurisë dhe shumës së vlerës së marrë dhe të arkëtueshme njihet në fitim ose humbje. Banka çregjistron detyrimet financiare atëherë, dhe vetëm atëherë, kur detyrimet e Bankës janë të shlyera, anuluar ose kanë skaduar. Diferenca midis vlerës kontabël të detyrimit financiar të çregjistruar dhe shumës së paguar dhe të pagueshme njihet në fitim ose humbje.

Testi VPPI (vetëm pagesa e principalit dhe interesit mbi shumën e principalit të papaguar)

Hapi i dytë në klasifikimin e aseteve financiare në portofoliot që "mbahen për të mbledhur" lidhet me vlerësimin nëse rrjedhjet kontraktuale të parave janë të konsistente me testin VPPI. Shuma e principalit pasqyron vlerën e drejtë në njohjen fillestare minus çdo ndryshim të mëvonshëm, p.sh. për shkak të shlyerjes. Interesi duhet të përfaqësojë vetëm konsideratë për vlerën në kohë të parasë, rrezikun e kredisë, rreziqet e tjera bazë të huadhënies dhe një marzh fitimi në përputhje me karakteristikat bazë të huadhënies. Nëse rrjedhjet e parave sjellin më shumë se ekspozim minimal ndaj rrezikut ose paqëndrueshmërisë që nuk është në përputhje me tiparet bazë të huadhënies, asseti financiar njihet detyrimisht në VDPFH.

Në përgjithësi, portofolet e aseteve financiare të Bankës që "mbahen për të mbledhur" kanë rrjedhje kontraktuale të parave që janë përgjithësisht në përputhje me testin VPPI.

Banka njih provizionet e humbjeve për HPK në instrumentet financiare të mëposhtme që nuk maten me VDPFH:

- asetet financiare që janë instrumente borxhi; dhe
- angazhimet e kredisë dhe kontratat e garancisë financiare të lëshuara.

Shkallët e rrezikut kreditor

Banka shpërndan çdo ekspozim ndaj një shkalle të rrezikut të kredisë bazuar në kërkesat e përcaktuara nga rregullorja e Menaxhimit të Riskut të Kredisë duke përdorur faktorë cilësor dhe sasior që janë tregues të rrezikut të mos mospagimit.

Çdo ekspozim do të ndahet në një shkallë të rrezikut të kredisë në njohjen fillestare bazuar në informacionin e disponueshëm në lidhje me huamarrësit. Ekspozimet do t'i nënshtrohen një monitorimi të vazhdueshëm, i cili mund të rezultojë në një ekspozim të zhvendosur në një shkallë të ndryshme të rrezikut të kredisë.

3. POLITIKAT E MATERIALE KONTABËL (VAZHDIM)

(g) Pasuritë dhe detyrimet financiare

Rritje e ndjeshme e rrezikut të kredisë

Rritja e ndjeshme e rrezikut të mospagimit dhe rënia në vlerë, në vetvete janë përcaktuesit kryesorë për llogaritjen e humbjeve të pritshme të kredisë.

Në çdo datë raportimi, Banka vlerëson nëse ka pasur një rritje të konsiderueshme të rrezikut të kredisë duke krahasuar:

(i) rrezikun që kredia të mos paguhet në ose pas datës së raportimit me

(ii) Rreziku i mospagimit të vlerësuar në ose pas datës së njohjes fillestare të tij.

Përcaktimi nëse riskuti kreditor është rritur ndjeshëm dhe përkufizimi i mospagesës

Sipas SNRF 9, kur përcaktohet nëse rreziku i kredisë (d.m.th. rreziku i vonesës) në një instrument financiar është rritur ndjeshëm që nga njohja fillestare, Banka do të konsiderojë informata të arsyeshme dhe të mbështetshme që janë relevante dhe të disponueshme pa kosto ose përpjekje të panevojshme, informata cilësore dhe analiza bazuar në përvojën historike të Banka, vlerësimin e kreditor të ekspertëve dhe informacionin e ardhshëm.

Banka ka identifikuar nëse ka ndodhur një rritje e konsiderueshme e rrezikut të kredisë për një ekspozim që ndryshon klasifikimin e rrezikut rregullator nga standarde tek nën vërtetim në përputhje me politikën e Bankës për klasifikimin e rrezikut rregullator. Të gjitha kreditë që tregojnë rritje të konsiderueshme të rrezikut kreditor klasifikohen në Kategorinë 2.

Si një rezervë, dhe siç kërkohet nga SNRF 9, Banka konsideron me supozim se një rritje e konsiderueshme e rrezikut të kredisë ndodh jo më vonë se kur një pasuri është më shumë se 30 ditë të kaluara në vonesë. Banka përcakton ditët e kaluara në vonesë duke llogaritur numrin e ditëve që nga data më e hershme në vonesë për të cilën pagesa e plotë nuk është pranuar.

Përveq indikacionit të rezervës, Banka konsideron gjithashtu një rritje të konsiderueshme të rrezikut të kredisë nëse kredia klasifikohet nga standarde tek nën vërtetim ose një shkallë rreziku më poshtë ose kreditë e tjera të të njëjtit klient me Bankën klasifikohen nga standardi nën vërtetim ose në një shkallë më keq të rrezikut. Banka gjithashtu konsideron që rreziku është rritur nëse klienti kërkon një ristrukturim me kushte lehtësuese si: maturitet të zgjatur, këste më të ulëta, normë më të ulët interesi, heqje dorë nga dënimet e përllogaritura dhe kamata.

Faza 1:

Një përcaktues i rëndësishëm për llogaritjen e humbjes së pritshme të kredisë në përputhje me SNRF 9 është të vlerësojë nëse ka një rritje të konsiderueshme të rrezikut të kredisë të pasurisë financiare. Pasuritë financiare që nuk kanë pësuar një rritje të konsiderueshme të rrezikut të kredisë që nga njohja fillestare monitorohen në fazën e parë. Zhvlerësimi i rrezikut të kredisë për pasuritë financiare të Fazës 1 është i barabartë me humbjet e pritshme të kredisë 12-mujore.

Faza 2:

Pasuritë financiare që pësuan një rritje të konsiderueshme të rrezikut të kredisë që nga njohja fillestare, transferohen në fazën 2. Humbja e pritshme e kredisë së këtyre pasurive financiare matet në një shumë të barabartë me humbjen e pritshme të kredisë nga instrumenti.

3. POLITIKAT E MATERIALE KONTABËL (VAZHDIM)

(g) Pasuritë dhe detyrimet financiare (vazhdim)

Përcaktimi nëse riskuti kreditor është rritur ndjeshëm dhe përkufizimi i mospagesës (vazhdim)

Për të klasifikuar një pasuri financiar në fazën e dytë, merren parasysh kriteret e mëposhtme:

- E vonuar më shumë se 30 dhe më pak se ose e barabartë me 90 ditë
 - Ristrukturimi i kredisë
 - Kur një instrument kredie ka shfaqur një përkeqësim të konsiderueshëm që nga fillimi, Banka regjistron një provizion bazuar në PD-në e përjetshme.
 - Lehtësirat e kredisë, ku rreziku i kredisë është përmirësuar dhe kredia është riklasifikuar nga Faza 3 në Fazën 2.
- Në rast të një përkeqësimi të konsiderueshëm të probabilitetit të mospagimit, rreziku i kredisë konsiderohet të rritet ndjeshëm dhe aktivi financiar klasifikohet si faza 2. Kufiri absolut dhe gradual i përdorur për të rritur probabilitetin e mospagimit diferencohen në bazë të lloji i portofolit.

Faza 3:

Pasuritë financiare me informacion të mjaftueshëm dhe të drejtë për zhvlerësim në datën e raportimit, klasifikohen në fazën e tretë. Humbja e pritshme e kreditit e këtyre pasurive financiare matet në një shumë të barabartë me humbjen e pritshme të kredisë.

Kalimi në fazën 3 realizohet kur pasuria financiare është e paaautorizuar. Një mospagim konsiderohet të ketë ndodhur në lidhje me një detyrues të veçantë ose për një pasuri financiare kur kanë ndodhur njëra ose të dyja këto dy ngjarje vijuese.

- Banka konsideron se detyruesi nuk ka gjasa të paguajë plotësisht detyrimet e tij të kredisë ndaj Degës, pa rekurs nga Dega në veprime të tilla si realizimi i sigurisë (nëse mbahet).
- Pasuritë financiare kanë kaluar më shumë se 90 ditë vonesë.

Vlefshmëria e vlerësimeve të parametrave të rrezikut të përdorura në llogaritjen e humbjeve të pritshme të kredisë, rishikohet dhe vlerësohet të paktën çdo vit brenda kornizës së proceseve të vlerësimit të modelit. Parashikimet makroekonomike dhe të dhënat e delikuencës së rreziqeve të përdorura në modelet e parametrave të rrezikut, rishikohen çdo tremujor për të pasqyruar ndryshimet në konjunkturën ekonomike dhe azhurnohen nëse është e nevojshme.

Ndërsa llogaritjet humbja e pritshme e kredisë, përveç vlerësimit nëse ka një rritje të konsiderueshme të rrezikut të kredisë apo jo, përdoren parametrat bazë të shprehura si probabiliteti i mospagimit, humbja e dhënë si dhe ekspozimi në parazgjedhje.

3. POLITIKAT E MATERIALE KONTABËL (VAZHDIM)

(g) Pasuritë dhe detyrimet financiare (vazhdim)

Metodologjia për llogaritjen e HPK-së

Llogaritja e probabilitetit të dështimit (PD)

Probabiliteti i dështimit: Përfaqëson gjasat e një mospagimi gjatë një periudhe kohe të caktuar.

Në këtë kontekst, Banka ka zhvilluar modele për të llogaritur probabilitetin e paracaktuar 12-mujor dhe të kohës së jetës, duke përdorur vlerësimin e brendshëm bazuar në modelet e vlerësimit të kredisë.

Është bërë një ndarje të portofolit të kredisë bazuar në karakteristikat e ngjashme të rrezikut me qëllimet e llogaritjes së probabilitetit të mospagimit. Më poshtë janë paraqitur segmentet e portofolit të kredisë:

- Kredi biznesore
- Kredi individuale

Llogaritja e PD-së 12-mujore bëhet në baza mujore për të gjithë periudhën e të dhënave historike dhe mesatarja afatgjatë e PD-ve përdoret për biznesin dhe portofolin individual veç e veç.

PD gjatë gjithë jetës së kredisë, llogaritet duke shtuar faktorët e jashtëm (benchmarking) mbi PD 12-mujore. Në këtë drejtim, ndryshimi i raportit të KJP nga viti 2015 në 2022 është përdorur si faktor i jashtëm. Pra, merret parasysh që nëse raporti i KJP në treg do të arrijë mesataren statistikore (përgjatë viteve 2015 - 2022) kjo do të ndikojë në probabilitetin e mospagimit edhe të Degës ISBANK. TA (treguesit/ informacionit të së ardhmës) janë përfshirë në PD në një model të ri HPK. Variabla të jashtëm alternativë, të tillë si rritja e parashikuar reale e PBB-së dhe inflacioni gjatë pesë viteve të ardhshme, janë marrë nga Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN) për t'u përfshirë në model.

Kalkulimi i kredive në dështim (KND)

Kreditë në dështim: Përcaktohet si dëmi i shkaktuar nga mospagimi i huamarrësit në bilancin e përgjithshëm të ekspozimit në kohën e parazgjedhjes. Vlerësimet e KND përcaktohen në lidhje me grupet e rrezikut të kredisë, të hollësisht në burimet e të dhënave të Bankës dhe lehtësitë e sistemit. Modeli i përdorur për vlerësimin e KND u krijua duke marrë parasysh artikujt e kostos direkte gjatë procesit të mbledhjes, bazuar në të dhënat historike të mbledhjes së borxheve të Bankës, flukset e parave zbriten me norma efektive të interesit.

Ka pasur një grupim në segmentet vijuese të portofolit të kredisë me qëllimet e llogaritjes së KND:

- Kredi biznesore
- Kredi individuale

Banka rishikon në baza vjetore kufijtë dhe kriteret e përcaktuara për të siguruar që ato të mbeten të vlefshme pas ndryshimeve të mundshme në madhësinë dhe përbërjen e portofolit të kredive.

Ekspozimi ndaj dështimit:

Për kreditë e mbuluara me para, bilanci i parave të gatshme në datën e raportimit, për kreditë që nuk janë të mbuluara me para, bilanci i llogaritur duke përdorur Faktorin e Konvertimit të Kredisë përfaqësohet nga ekspozimi ndaj dështimit. Faktori i Konvertimit të Kredisë: Vlerësohet për kreditë jo- në para (kufiri i papaguar për të rinovueshme, angazhime, kredi- jo në para, etj.) Të dhënat e limitit historik të përdorimit të Bankës për kreditë rrotulluese janë: analizuar dhe shuma e limitit që mund të përdoret deri në vlerësohet koha e paracaktuar. Për kreditë pa para, raporti i konvertimit të huasë në para vlerësohet duke analizuar llojin e produktit dhe shumën e kompensimit të kaluar bankar. Përfaqëson gjendjen në datën e raportit. Humbja e pritur e kredisë pasqyrohet në pasqyrën e të ardhurave. Dispozitat e lëshuara në vitin aktual llogariten nën "Humbjet e Kredisë së Pritshme", pjesa e lëshuar pa provizione të përcaktuara në vitet e kaluara transferohet në "Të ardhura të tjera operative".

3. POLITIKAT E MATERIALE KONTABËL (VAZHDIM)

(g) Pasuritë dhe detyrimet financiare (vazhdim)

Pasuritë e modifikuara financiare

Kushtet kontraktuale të një kredie mund të modifikohen për një numër arsyes, duke përfshirë ndryshimin e kushteve të tregut, mbajtjen e klientit dhe faktorë të tjerë që nuk lidhen me një përkeqësim të kredisë aktuale ose të mundshme të klientit. Një kredi ekzistuese, kushtet e të cilës janë modifikuar mund të ç'regjistrohet dhe kredia e rinegociuar të njihet si një kredi e re me vlerën e drejtë.

Sipas SNRF 9, kur kushtet e një pasurie financiar janë modifikuar dhe modifikimi nuk rezulton në ç'regjistrim, Banka do të marrë në konsideratë nëse rreziku i kredisë së pasurisë është rritur ndjeshëm duke analizuar faktorët sasiorë dhe cilësor që ndikojnë në rrezikun e mospagimit.

Banka rinegocion kredi për klientët në vështirësi financiare (të referuara si 'aktivitete të mbajtjes së borxheve') për të maksimizuar mundësitë e mbledhjes dhe për të minimizuar rrezikun e mospagimit. Sipas politikës së mbajtjes së borxhit të Bankës, heqja dorë nga huaja jepet në bazë selektive nëse debitori aktualisht nuk është në mospagesë të borxhit të tij, ose nëse ekziston një rrezik i lartë i mospagesës, ka prova që debitori ka bërë të gjitha përpjekjet e arsyeshme për të paguar sipas kushteve kontraktuale dhe debitori pritët të jetë në gjendje të përbushë kushtet e rishikuara.

Në përgjithësi, ristrukturimi është një tregues cilësor i rënjes së verës të kredisë dhe pritjet e ristrukturimit janë të rëndësishme për të vlerësuar nëse ka një rritje të konsiderueshme të rrethit të kredisë.

Pas ristrukturimit, një klient duhet të tregojë sjellje të mirë pagese në mënyrë të vazhdueshme gjatë tetë muajve përpara se ekspozimi të matet në një shumë të barabartë me HPK-të 12-mujore.

Paraqitja e lejimeve për HPK në pasqyrën e pozicionit financiar

Lejimet e humbjes për HPK paraqiten në pasqyrën e pozicionit financiar si më poshtë:

- pasuritë financiare të matura me koston e amortizuar: si zbritje nga vlera kontabël bruto e pasurive;
- zotimet e kredisë dhe kontratat e garancioneve financiare: përgjithësisht, si provizion;
- instrumente të matura me koston e amortizuar: lejimi i humbjes njihet në pasqyrën e pozicionit financiar.

(iii) Shlyerja e pasurive

Banka shlyen pasuritë financiare, tërësisht ose pjesërisht, kur ka shteruar të gjitha përpjekjet praktike të rimëkëmbjes dhe ka konkluduar se nuk ka ndonjë pritje të arsyeshme të rimëkëmbjes. Treguesit se nuk ka ndonjë pritje të arsyeshme të rimëkëmbjes përfshijnë (i) ndërprerjen e veprimtarisë përmbarimore dhe (ii) kur metoda e rimëkëmbjes së Bankës është mbyllje e detyrueshme mbi kolateralin dhe vlera e kolateralit është e tillë që nuk ka ndonjë pritje të arsyeshme të rikuperimit të plotë. Banka mund të fshijë pasuritë financiare që janë ende subjekt i veprimtarisë përmbarimore.

(h) Kreditë dhe të arkëtueshmet

Kreditë dhe arkëtimet janë pasuri financiare jo-derivative me pagesa fikse ose të përcaktueshme që nuk janë kuotuar në një treg aktiv. Huatë dhe paradhëniet për bankat, huatë dhe paradhëniet për klientët klasifikohen si kredi dhe të arkëtueshme.

Të gjitha kreditë dhe paradhëniet fillimisht njihen me vlerën e drejtë. Pas njohjes fillestare, këto më pas maten me kosto të amortizuar duke përdorur metodën efektive të normës së interesit. Kostoja e amortizuar llogaritet duke marrë parasysh çdo kosto të emetimit dhe çdo zbritje ose prime të shlyerjes.

Huatë dhe paradhëniet raportohen në vlerën neto pa vlerën e provizioneve për humbjet e kredisë.

3. POLITIKAT E MATERIALE KONTABËL (VAZHDIM)

(i) Paraja dhe ekuivalentët e saj

Paraja dhe ekuivalentët e saj përfshijnë banknotat dhe monedhat në qarkullim, balancat e pakufizuara që mbahen në bankat qendrore dhe pasuritë që janë shumë likuide me maturitet fillestar më pak se tre muaj, të cilat i nënshtrohen rrezikut të parëndësishëm të ndryshimit në vlerën e tyre të drejtë dhe përdoren nga Banka në menaxhimin e zotimeve afatshkurtëra.

Paraja dhe ekuivalentët e saj mbahen sipas koston së amortizuar në pasqyrën e pozitës financiare.

(j) Depozitat dhe huatë

Depozitat dhe huatë janë burimi kryesor i financimit të Bankës.

Depozitat në fillim maten sipas vlerës së drejtë minus kostot direkte të transaksionit, dhe më pas maten sipas koston së amortizuar duke përdorur metodën efektive të interesit.

(k) Pasuritë riposeduara

Kolaterali i mbajtur si pjesë e marrëveshjes për kredi mund të riposedohet nga Banka vetëm në rastet kur huamarrësi dështon të paguajë si dhe kur Banka merrë masat ligjore në përputhje me legjislacionin në Kosovë të cilat ia mundësojnë Bankës titullin ligjorë dhe pronësinë mbi pasurinë. Banka mund të shesë apo transferoj kolateralin vetëm pas kompletimit të këtyre procedurave. Pasuritë e riposeduara fillimisht njihen në vlerën e përcaktuar nga urdhëri gjykatës si dhe më pas maten sipas koston më të ulët dhe vlerës neto të realizueshme dhe ndonjë fitim apo humbje nga shitja e këtyre pasurive njihet si humbje apo fitim.

Nga njohja fillestare Banka e klasifikon pasurinë e riposeduar minimum në kategorinë substandarde si dhe përlllogaritë provizionin sipas klasifikimit. Gjithashtu, Banka e njeh kolateralin e riposeduar si pasuri vetëm kur e ka titullin ligjor të plotë të kolateralit si dhe kur mund të përcaktohet vlera e drejtë e kolateralit në mënyrë të sigurt. Banka nuk mund të shesë, transferoj apo rizotoj kolateralin nëse procedurat ligjore për transferimin e pronësisë, si rezultat i mospagesës, nuk kanë përfunduar. Banka mbanë posedimin e pronës, të fituar nëpërmjet detyrimit ligjor, në formë të hipotekës për një periudhë maksimale prej 5 vjetësh. Nëse përgjatë këtyre 5 viteve pasuria nuk është shitur nga Banka, vlera e pasurisë bëhet zero.

(l) Letrat me vlerë

Letrat me vlerë të investimit përfshijnë letrat me vlerë të investimit të borxhit të matura me kosto të amortizuar; këto maten fillimisht me vlerën e drejtë plus kostot shtesë të transaksionit direkt, dhe më pas me koston e tyre të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv.

(m) Provizionet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i ngjarjeve të mëparshme, Banka ka një detyrim ligjor ose konstruktiv i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme, dhe është e mundur që benifitet ekonomike do të kërkohen për të shlyer detyrimin. Provizionet përcaktohen duke diskontuar vlerën e ardhshme të parasë me një normë para tatimit e cila reflekton vlerësimin aktual të tregut për vlerën kohore të parasë dhe rreziqet specifike ndaj detyrimit. Lëshimet e diskontimit njihen si kosto financiare.

(n) Përfitimet e punonjësve

(i) Kontributet e obligueshme të sigurimit shoqëror

Banka bënë vetëm pagesa të kontributeve të obligueshme që ofrojnë përfitim të pensionit për punonjësit pasi të pensionohen. Qeveria e Kosovës është përgjegjëse për të ofruar minimumin e pensionit të Kosovës sipas planit të definuar të pensionit. Kontributet e Bankës në planin pensional ngarkohen në fitim ose humbje në momentin e ndodhjes.

3. POLITIKAT E MATERIALE KONTABËL (VAZHDIM)

(o) Prona dhe pajisjet

(i) Njohja dhe matja

Zërat e pronës dhe pajisjeve janë paraqitur sipas kostos minus zhvlerësimit të akumuluar dhe humbjeve nga dëmtimet.

Kosto përfshinë shpenzimet të cilat i atribuohen direkt blerjes së pasurisë.

Kur pjesët e një zëri të pronës, impianteve dhe pajisjeve kanë jetë të ndryshme të përdorimit, ato trajtohen si zëra të veçantë (komponenta kryesore) të impianteve dhe pajisjeve.

Çdo fitim ose humbje që lind me rastin e shitjes së një zëri të pronës, impianteve dhe pajisjeve, përcaktohet si diferencë midis të ardhurave nga shitja dhe vlerës kontabël neto të pasurisë, dhe njihet në fitim ose humbje.

(ii) Kostot pasuese

Kosto e zëvendësimit të një pjese të pronës dhe pajisjeve njihet sipas vlerës bartëse të zërit nëse përfitimi i ardhshëm ekonomik i integruar brenda pjesës së pasurive është i mundshëm të rrjedhë në kompani dhe kosto e tij mund të matet me besueshmëri. Kostot e servisit të pronës dhe pajisjeve nga dita në ditë njihen në pasqyrën e fitimit ose humbjes kur ato ndodhin.

(iii) Amortizimi

Amortizimi njihet në pasqyrën e fitimit ose humbjes sipas metodës lineare përgjatë jetës së vlerësuar të përdorimit të pasurive. Metodatat e zhvlerësimit, jetët e përdorimit dhe vlerat e mbetura (nëse nuk janë domethënëse) rivlerësohen në datën e raportimit.

Jetët e vlerësuar të përdorimit për periudhat e tanishme dhe krahasuese ishin siç vijon:

- | | |
|---------------------------------|--------|
| • Pajisjet dhe mbylljet e zyrës | 5 vite |
| • Pasuritë tjera fikse | 5 vite |

Përmirësimet e objekteve me qera zhvlerësohen në afatin 3 dhe 10 vite, varësisht se cila është më e shkurtër afati i qirasë apo jetëa e tyre e dobishme.

(p) Pasuritë e paprekshme

Pasuritë e paprekshme me jetë të caktuar të përdorimit dhe të cilat janë blerë ndaras njihen sipas kostos minus amortizimit të akumuluar dhe humbjeve nga dëmtimet. njihet duke përdorur metodën lineare përgjatë jetës së dobishme të pasurisë. Jeta e përdorimit dhe metoda e rishikohet në fund të secilës datë të raportimit, ndërsa çfarëdo ndryshimi ka efekt dhe merret parasysh për të ardhmen.

Jeta e dobishme e softuerit është pesë vjet.

(q) Garancionet financiare dhe zotimet për kredi

Garancionet financiare janë kontrata të cilat kërkojnë nga Banka që të bëjë pagesa specifike për të rimbursuar poseduesin për ndonjë humbje që mund të ndodhë për shkak të dështimit për të paguar ndonjë huamarrës i caktuar në përputhje me kushtet e instrumentit të huamarrjes. Zotimet për kreditë janë zotime të Bankës që të afrojnë kredi në përputhshmëri me afatet dhe kushtet e paracaktuara. Zotimet e tilla financiare regjistrohen në pasqyrën e pozitës financiare nëse dhe atëherë kur bëhen të pagueshme.

4. ZBATIMI I STANDARDEVE DHE INTERPRETIMEVE TË REJA OSE TË RISHIKUARA

(i) Standardet dhe interpretimet efektive për periudhën raportuese

- **SNRF 17 “Kontratat e sigurimit”** botuar nga BSNK më 18 maj 2017. Standardi i ri kërkon që detyrimet e sigurimit të maten me një vlerë aktuale të përmbushjes dhe ofron një qasje më uniforme matje dhe paraqitje për të gjitha kontratat e sigurimit. Këto kërkesa janë krijuar për të arritur qëllimin e një kontabiliteti konsistent dhe të bazuar në parime për kontratat e sigurimit. SNRF 17 zëvendëson SNRF 4 “Kontratat e sigurimit” dhe interpretimet përkatëse kur zbatohet. Ndryshimet në SNRF 17 “Kontratat e sigurimit” të lëshuara nga BSNK më 25 qershor 2020 shtyjnë datën e zbatimit fillestar të SNRF 17 me dy vjet, për periudhat vjetore që fillojnë më 1 janar 2023. Për më tepër, ndryshimet e lëshuara më 25 qershor 2020 paraqesin thjeshtime dhe sqarime të disa kërkesave në Standard dhe ofrojnë lehtësira shtesë kur zbatohet SNRF 17 për herë të parë.

Miratimi i këtij standardi të ri nuk ka çuar në ndonjë ndryshim në pasqyrat financiare të Bankës.

- **Ndryshimet në SNK 1 “Prezantimi i Pasqyrave Financiare” - Dhënia e informacioneve shpjeguese të politikave kontabël të publikuara nga BSNK më 12 shkurt 2021.** Ndryshimet kërkojnë që njësitë ekonomike të japin informacion shpjegues për politikën e tyre kontabël materiale në vend të politikave të tyre të rëndësishme kontabël dhe të ofrojnë udhëzime dhe shembuj për të ndihmuar përgatitësit të vendosin se cilat politika kontabël të shpalosin në pasqyrat e tyre financiare. Menaxhmenti rishikoi politikën e kontabilitetit dhe bëri përditësime të informacionit të shpalosur në shënimin 3 Politikën materiale kontabël (2022: Politika kontabël të rëndësishme) në raste të caktuara në përputhje me ndryshimet.
- **Ndryshimet në SNK 8 “Politikat kontabël, ndryshimet në vlerësimet kontabël dhe gabimet” - Përkufizimi i vlerësimeve kontabël** të publikuar nga BSNK më 12 shkurt 2021. Ndryshimet fokusohen në vlerësimet kontabël dhe ofrojnë udhëzime se si të bëhet dallimi midis politikave kontabël dhe vlerësimeve kontabël. Miratimi i këtyre ndryshimeve nuk ka çuar në ndryshime në pasqyrat financiare të Bankës.
- **Ndryshimet në SNK 12 “Tatimet mbi të Ardhurat” - Tatimi i shtyrë në lidhje me pasuritë dhe detyrimet që rrjedhin nga një transaksion i vetëm** i lëshuar nga BSNK më 6 maj 2021. Sipas ndryshimeve, përjashtimi nga njohja fillestare nuk zbatohet për transaksionet në të cilat diferencat e përkohshme të zbritshme dhe të tatueshme lindin në njohjen fillestare që rezultojnë në njohjen e aktiveve dhe detyrimeve të barabarta tatimore të shtyra. Për qiratë, Banka ka njohur më parë aktivin ose detyrimin tatimor të shtyrë në bazë neto. Pas ndryshimit, banka ka njohur një aktiv tatimor të shtyrë të veçantë në lidhje me detyrimet e qirasë dhe një detyrim tatimor të shtyrë në lidhje me aktivet e saj të së drejtës së përdorimit. Megjithatë, nuk kishte asnjë ndikim në pasqyrën e pozicionit financiar sepse teprica kualifikohet për kompensim sipas paragrafit 74 të SNK 12. Ndikimi kryesor për Bankën lidhet me dhënien e informacioneve shpjeguese të aktiveve dhe detyrimeve tatimore të shtyra të njohura.
- **Ndryshimet në SNK 12 “Tatimet mbi të Ardhurat” - Reforma Ndërkombëtare e Tatimeve - Rregullat Model Shtylla e Dytë** të lëshuara nga BSNK më 23 maj 2023. Ndryshimet prezentuan një përjashtim të përkohshëm nga kontabilizimi për tatimet e shtyra që rrjedhin nga juridiksionet që zbatojnë rregullat globale të taksave dhe kërkesat për dhënie informacionesh shpjeguese në lidhje me ekspozimin e kompanisë ndaj taksave mbi të ardhurat që rrjedhin nga reforma, veçanërisht përpara se legjislacioni që zbaton rregullat të hyjë në fuqi. Miratimi i këtyre ndryshimeve nuk ka çuar në ndryshime në pasqyrat financiare të Bankës.

4. ZBATIMI I STANDARDEVE DHE INTERPRETIMEVE TË REJA OSE TË RISHIKUARA

(ii) Standardet dhe ndryshimet në standardet ekzistuese jo efektive për periudhën raportuese

Në datën e autorizimit të këtyre pasqyrave financiare, ndryshimet e mëposhtme në standardet ekzistuese nga BSNK nuk janë ende efektive:

- **Ndryshimet në SNRF 16 “Qiratë” - Detyrimi i Qirasë në një shitje dhe rimarrja me qira** të lëshuar nga BSNK më 22 shtator 2022. Ndryshimet në SNRF 16 kërkojnë që një shitës-qiramarrës të masë më pas detyrimet e qirasë që rrjedhin nga një rimarrje me qira në një mënyrë që ai të mos njohë asnjë shumë të fitimit ose humbjes që lidhet me të drejtën e përdorimit që ruan. Kërkesat e reja nuk e pengojnë një shitës-qiramarrës që të njohë në fitim ose humbje çdo fitim ose humbje në lidhje me përfundimin e pjesshëm ose të plotë të qirasë (Data në fuqi është 1 janar 2024).
- **Ndryshimet në SNK 1 “Prezantimi i Pasqyrave Financiare” - Klasifikimi i Detyrimeve afatshkurtëra ose afatgjata** të lëshuara nga BSNK më 23 janar 2020 dhe **Ndryshimet në SNK 1 “Prezantimi i Pasqyrave Financiare” - Detyrimet afatgjata të kushtëzuara** të lëshuara nga BSNK më 31 tetor 2022. Ndryshimet e lëshuara në janar 2020 ofrojnë një qasje më të përgjithshme për klasifikimin e detyrimeve sipas SNK 1 bazuar në marrëveshjet kontraktuale në fuqi në datën e raportimit. Ndryshimet e nxjerra në tetor 2022 sqarojnë se si kushtet të cilat një kompani duhet të përmbushë brenda dymbëdhjetë muajve pas periudhës raportuese ndikojnë në klasifikimin e një detyrimi dhe caktojnë datën efektive për të dy ndryshimet për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2024.
- **Ndryshimet në SNK 7 “Pasqyra e Rrjedhës së Parasë” dhe SNRF 7 “Instrumentet Financiare: Dhënia e informacioneve shpjeguese” - Marrëveshjet financiare të furnizuesve** të lëshuara nga BSNK më 25 maj 2023. Ndryshimet shtojnë kërkesat për dhënie informacionesh shpjeguese dhe “tabela sqaruese” brenda kërkesave ekzistuese për dhënie informacionesh shpjeguese cilësore dhe sasiore në lidhje me marrëveshjet financiare të furnizuesit (Data në fuqi është 1 janar 2024).
- **Ndryshimet në SNK 21 “Efektet e ndryshimeve në kurset e këmbimit valutor” - Mungesa e këmbyeshmërisë** të lëshuar nga BSNK më 15 gusht 2023. Ndryshimet përmbajnë udhëzime për të specifikuar kur një monedhë është e këmbyeshme dhe si të përcaktohet kursi i këmbimit kur nuk është në dispozicion (Data në fuqi është 1 janar 2025).
- **Ndryshimet në SNRF 10 “Pasqyrat Financiare të Konsoliduara” dhe SNK 28 “Investime në pjesëmarrje dhe sipërmarrje të përbashkëta” - Shitja ose kontributi i pasurive ndërmjet një investitori dhe bashkëpunëtorit të tij ose sipërmarrjes së përbashkët** të lëshuar nga BSNK më 11 shtator 2014. Ndryshimet trajtojnë një konflikt midis kërkesave të SNK 28 dhe SNRF 10 dhe sqarojnë se në një transaksion që përfshin një pjesëmarrje ose sipërmarrje të përbashkët, shkalla e njohjes së fitimit ose humbjes varet nëse pasuritë e shitura ose të kontribuuara përbëjnë një biznes (në dispozicion për miratim opsional/data e hyrjes në fuqi e shtyrë për një kohë të pacaktuar).

Banka parashikon që miratimi i këtyre standardeve të reja dhe ndryshimet në standardet ekzistuese nuk do të kenë ndikim material në pasqyrat financiare të Bankës në periudhën e aplikimit fillestar.

5. INFORMACION PËR VLERËN E DREJTË

a) Përcaktimi i vlerës të drejtë

Përcaktimi i vlerës së drejtë të pasurive dhe detyrimeve financiare për të cilat nuk ka çmim tregu kërkon përdorimin e teknikave të vlerësimit siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentet financiare që tregtohen rrallë dhe kanë pak transparencë të çmimeve, vlera e drejtë është më pak objektive dhe kërkon nivele të ndryshme gjykimi në varësi të likuiditetit, përqendrimit, pasigurisë së faktorëve të tregut, supozimeve rreth çmimit dhe risqe të tjera që ndikojnë në instrumentin specifik.

Banka vlerëson vlerën e drejtë duke shfrytëzuar hierarkinë e mëposhtme të metodave:

- Niveli 1: Çmim i kuotuar i tregut në tregje aktive për instrumentet identike;
- Niveli 2: Metodë vlerësimi bazuar në inpute të vlerësueshme. Kjo kategori përfshinë instrumentet e vlerësuar duke shfrytëzuar: çmimet e tregut për instrumente të ngjashme në tregjet aktive; çmimet e tregut për instrumente të ngjashme në tregjet më pak aktive; apo teknika tjera të vlerësimit në të cilat të gjithë faktorët material në menyrë direkte apo indirekte janë të vëzhgueshëm nga të dhënat e tregut;
- Niveli 3: Metodë vlerësimi bazuar në inpute të rëndësishme jo të vëzhgueshme. Kjo kategori përfshinë të gjithë instrumentet për të cilët teknikat e vlerësimit përfshijnë faktor që nuk bazohen në të dhëna të vëzhgueshme dhe faktorët e pavëzhgueshëm kanë një ndikim material në vlerësimin e instrumentit. Kjo kategori përfshinë instrumentet që janë vlerësuar në bazë të çmimeve të tregut për instrumente të ngjashme për të cilat rregullime apo gjykime materiale jo të vëzhgueshme kërkojnë për të reflektuar dallimet mes instrumenteve.

Vlerësimi i vlerës së drejtë është shpalosur në shënimin më poshtë.

Türkiye İş Bankası A.Ş.- DEGA NË KOSOVË
PASQYRAT FINANCIARE

Shënimet e pasqyrave financiare më dhe për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2023
(Shumat në Euro, përveç nëse është specifikuar ndryshe)

5. INFORMACION PËR VLERËN E DREJTË (VAZHDIM)

b) Paraqitja dhe vlerësimi i vlerës së drejtë

Instrumentet financiare - hierarkia e vlerës së drejtë

Tabela e mëposhtme paraqet vlerat e drejta të instrumenteve financiare dhe i analizon ato sipas nivelit në hierarkinë e vlerës së drejtë në të cilën kategorizohet çdo matje e vlerës së drejtë. Gjatë vitit të mbyllur më 31 dhjetor 2023, nuk ka pasur transferime brenda dhe jashtë Niveli 2 dhe Niveli 3.

	2023			2022		
	Vlera kontabël	Vlera e drejtë Niveli 2	Niveli 3	Vlera kontabël	Vlera e drejtë Niveli 2	Niveli 3
Pasuritë financiare të matura me vlerën e drejtë						
Depozitat me afat të caktuar në banka	1,242,791	1,242,791	-	-	-	-
Investimet në letra me vlerë	7,037,802	7,037,802	-	99,770	99,770	-
Paratë në dorë dhe në banka dhe gjendje me Bankën Qendrore	8,489,294	486,617	8,002,623	28,232,293	5,836,887	22,395,405
Kreditë dhe paradhëniet për bankat	101,970,836	-	101,064,589	93,045,345	-	92,306,031
Pasuri të tjera financiare	165,021	-	165,021	419,616	-	419,617
Detyrimet financiare jo të matura sipas vlerës së drejtë						
Detyrime ndaj klientëve	69,944,889	-	70,275,868	68,873,870	-	69,328,214
Detyrimet ndaj bankave dhe Zyrës Qendrore	22,213,281	22,339,404	-	18,045,856	18,076,769	-
Detyrimet tjera financiare	417,193	-	417,194	573,934	-	573,935

5. INFORMACION PËR VLERËN E DREJTË (VAZHDIM)

b) Paraqitja dhe vlerësimi i vlerës së drejtë (vazhdim)

Instrumentet financiare - hierarkia e vlerës së drejtë

Vlera e drejtë për pasuritë dhe detyrimet financiare të mësipërme janë përcaktuar duke përdorur nivelin 2 dhe 3 të inputeve të përshkruara më lartë.

Vlerësimet e vlerave së drejtë bazohen në instrumente ekzistuese financiare në pasqyrën e pozicionit financiar të Bankës pa u përpjekur për të vlerësuar vlerën e biznesit të pritshëm dhe vlerën e pasurive dhe detyrimeve që nuk konsiderohen instrumente financiare.

Depozitat me afat të caktuar në banka

Detyrimet nga bankat e tjera përfshijnë depozitat dhe llogaritë ndërbankare. Përderisa kreditë, paradhëniet dhe depozitat janë afatshkurtëra dhe/ose me norma të ndryshueshme, vlera e tyre e drejtë konsiderohet të jetë e barabartë me vlerën e tyre kontabël.

Investimet në letra me vlerë

Investimet përfshijnë bono thesari të lëshuara nga Qeveria e Kosovës të cilat blihen me qëllim mbajtjen e tyre deri në maturim. Vlera e drejtë është vlerësuar duke përdorur një model të qarkullimit të parave të zbritura bazuar në një kurbë të rendimentit aktual të përshtatshëm për afatin e mbetur deri në maturim.

Kreditë dhe paradhëniet për klientët

Kur transaksionet e vëzhgueshme të tregut nuk janë të disponueshme, vlera e drejtë vlerësohet duke përdorur modele vlerësimi, të tilla si teknikat e rrjedhjes së diskontuar të parave. Inputi në teknikat e vlerësimit përfshin humbjet e pritshme të kredisë gjatë gjithë jetës, normat e interesit dhe normat e parapagimit.

Portofolio i kredive të Bankës ka një vlerë të drejtë të vlerësuar afërsisht si e barabartë me vlerën e tij kontabël për shkak të natyrës së tyre afatshkurtër apo të normave të interesit të cilat përafrojnë me normat e tregut. Pjesa më e madhe e portofolios të kredive është subjekt i ndryshimit të çmimeve brenda një viti.

Detyrimet ndaj klientëve, detyrimet ndaj bankave dhe Zyrës Qendrore

Vlera e drejtë e detyrimeve ndaj klientëve dhe huamarrjeve afatshkurtër është vlerësuar duke përdorur teknikat e vlerësimit duke përdorur të dhëna të vëzhgueshme të tregut. Vlera e drejtë e depozitave të pagueshme sipas kërkesës është shuma e pagueshme në datën e raportimit.

Instrumente të tjera financiare

Për instrumentet e tjera financiare, vlera e drejtë barazohet me vlerën kontabël.

6. MENAXHIMI I RREZIKUT FINANCIAR

Procesi i menaxhimit të riskut dhe funksionet e përfshira në këtë proces janë një nga përgjegjësitë kryesore të Bordit të Drejtorëve të kompanisë mëmë. Departamenti i Menaxhimit të Rrezikut, i cili vepron në kuadër të Bordit të Drejtorëve, është organizuar në Njësinë e Menaxhimit të Rrezikut së Pasurive-Detyrimeve, Rrezikut Kreditor si dhe Njësisë Ekonomike Kapitale, Rreziku Operacional dhe Verifikimi i Modeleve dhe Njësia e Rreziqeve të Degëve.

Procesi i menaxhimit të riskut të Bankës është kryer në kuadër të politikave të riskut të cilat janë të vendosura nga Departamenti i Menaxhimit të Riskut dhe të nxjerra nga Bordi i Drejtorëve dhe standardeve të shkruara të cilat përmbajnë standardet e politikave të riskut.

Këto politika të cilat kanë hyrë në fuqi në përputhje me praktikat ndërkombëtare janë standarde të përgjithshme që përmbajnë: organizimin dhe fushëveprimin e funksionit të menaxhimit të rrezikut, politikat e matjes së rrezikut, detyrat dhe përgjegjësitë e grupit të menaxhimit të rrezikut, procedurat për përcaktimin e limiteve të rrezikut, mënyrat për të eliminuar shkeljet e limiteve dhe miratimin, konfirmimin që duhet të jepet në një shumëllojshmëri të ngjarjeve dhe situatave. Fushëveprimi dhe përmbajtja e sistemit të menaxhimit të riskut të Bankës është dhënë nga llojet kryesore të riskut.

Banka i ekspozohet rreziqeve të mëposhtme nga përdorimi i instrumenteve financiare:

- rreziku kreditor
- rreziku i likuiditetit
- rreziku i tregut
- rreziku operacional

Ky shënim paraqet informacione rreth ekspozimit të Bankës ndaj secilit nga rreziqet më lartë, objektivat e Bankës, politikat dhe proceset për matjen dhe menaxhimin e rrezikut si dhe menaxhimin e kapitalit nga Banka.

(a) Rreziku kreditor

Rreziku kreditor është rreziku i humbjeve financiare të bankës nëse klienti apo pala tjetër e një instrumenti financiar nuk arrin të përmbushë detyrimet kontraktuale, dhe vjen kryesisht nga kreditë e bankës për klientët, bankat e tjera dhe investimeve.

Rreziku kreditor përcaktohet si rreziku i dështimit nga mosperformimi me kërkesat ose dështimi për të përmbushur detyrimet pjesërisht ose tërësisht nga ana e klientëve në kontratën e transaksionit me Bankën. Metodologjia dhe përgjegjësitë e menaxhimit të rrezikut kreditor, kontrollit dhe monitorimit si dhe korniza e limiteve të rrezikut kreditor janë të përcaktuara me politikën e rrezikut kreditor. Banka përcakton, mat dhe menaxhon rrezikun kreditor të të gjitha produkteve dhe aktiviteteve. Bordi i Drejtorëve i rishikon politikat dhe strategjitë e rrezikut kreditor minimum në baza vjetore. Menaxhmenti i Lartë është përgjegjës për zbatimin e politikave të rrezikut kreditor të cilat janë të miratuara nga Bordi i Drejtorëve.

Si rezultat i kredive dhe analizave të rrezikut kreditor, të gjitha gjetjet i raportohen Bordit të Drejtorëve dhe Menaxhmentit të Lartë në baza të rregullta. Përveç transaksioneve dhe proceseve të vlerësimit të rrezikut kreditor, monitorimi i rrezikut kreditor i referohet poashtu edhe monitorimit dhe menaxhimit të kredive sipas sektorëve, sigurimit, gjeografisë, valutës, llojit të kredive si dhe vlerësimit kreditorë.

Si pjesë e menaxhimit të rrezikut të kredisë të Bankës, si dhe kufijve të kërkuar nga rregulloret ligjore, Banka përdor limitet e rrezikut për të ndërmarrë rrezikun maksimal të kredisë brenda grupeve ose sektorëve të rrezikut që Bordi i Drejtorëve përcakton.

Këto kufij përcaktohen në atë mënyrë që minimizojnë përqendrimin e rrezikut brenda sektorëve të veçantë. Kufijtë e tepërt të rrezikut deri në kërkesat ligjore dhe kufijtë e kufijve konsiderohen si një përjashtim. Bordi i Drejtorëve ka autorizimin të aprovojë përjashtime. Rezultatet e kontrollit të kufijve të rrezikut dhe vlerësimet e këtyre kufijve janë paraqitur nga Auditi i Brendshëm dhe Banka e Menaxhimit të Riskut tek Menaxhmenti dhe Bordi i Drejtorëve.

Banka përdor sisteme mbështetëse për vendimet e kredisë, të cilat janë krijuar për qëllime të menaxhimit të rrezikut të kredisë, vendimeve për huadhënien, kontrollit të procesit të kredisë dhe provizionimit të kredisë. Konsistenca e sistemeve të mbështetjes së vendimeve të kredisë me strukturën e aktiviteteve, madhësinë dhe kompleksitetin e Bankës shqyrtohet vazhdimisht. Sistemet e mbështetjes së vendimeve për kredi përfshijnë vlerësimin e Komitetit të Riskut dhe miratimin e Bordit të Drejtorëve. Kjo rregullohet nga procedura e brendshme "Autoriteti i Delegimit të Pushtetit".

Türkiye İş Bankası A.Ş.- DEGA NË KOSOVË
PASQYRAT FINANCIARE

Shënimet e pasqyrave financiare më dhe për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2023
(Shumat në Euro, përveç nëse është specifikuar ndryshe)

6. MENAXHIMI I RREZIKUT FINANCIAR (VAZHDIM)

(a) Rreziku kreditor (vazhdim)

Ekspozimi maksimal ndaj rrezikut kreditor

Ekspozimet maksimale ndaj rrezikut të kredisë para kolateralit dhe përmirësime të tjera të kredisë më 31 dhjetor 2023 dhe 31 dhjetor 2022 janë si më poshtë:

	31 dhjetor 2023	31 dhjetor 2022
Balanca në Bankën Qendrore të Kosovës	8,002,623	22,395,405
Paraja në banka	166,241	5,554,128
Depozitat me afat të caktuar në banka	1,242,791	-
Kreditë dhe avanset për klientët, neto	101,970,836	93,045,345
Investimet në letra me vlerë me kosto të amortizuar	7,037,802	99,770
Garancionet në llogari të klientave dhe zotimet për kreditë	12,079,524	21,002,041
Të arkëtueshme të tjera	29,766	18,720
Ekspozimi maksimal ndaj riskut të kredisë	130,529,583	142,115,409

Kualiteti i kredive sipas klasës së pasurive financiare:

31 dhjetor 2023	As në vonesë e as të provizionuara	Në vonesë por jo të provizionuara	Në vonesë dhe të provizionuara	Gjithsej
Balanca në Bankën Qendrore të Kosovës	8,002,623	-	-	8,002,623
Paraja në banka	166,241	-	-	166,241
Depozitat me afat të caktuar në banka	1,242,791	-	-	1,242,791
Kreditë dhe avanset për klientët, neto	99,303,281	355,051	2,312,504	101,970,836
Investimet në letra me vlerë me kosto të amortizuar	7,037,802	-	-	7,037,802
Garancionet në llogari të klientave dhe zotimet për kreditë	12,079,524	-	-	12,079,524
Të arkëtueshme të tjera	29,766	-	-	29,766
Ekspozimi maksimal ndaj riskut të kredisë	127,862,028	355,051	2,312,504	130,529,583

31 dhjetor 2022	As në vonesë e as të provizionuara	Në vonesë por jo të provizionuara	Në vonesë dhe të provizionuara	Gjithsej
Balanca në Bankën Qendrore të Kosovës	22,395,405	-	-	22,395,405
Paraja në banka	5,554,128	-	-	5,554,128
Kreditë dhe avanset për klientët, neto	89,075,736	132,304	3,837,304	93,045,344
Investimet në letra me vlerë me kosto të amortizuar	99,770	-	-	99,770
Garancionet në llogari të klientave dhe zotimet për kreditë	20,997,704	-	4,337	21,002,041
Të arkëtueshme të tjera	18,720	-	-	18,720
Ekspozimi maksimal ndaj riskut të kredisë	138,141,463	132,304	3,841,641	142,115,409

Türkiye İş Bankası A.Ş.- DEGA NË KOSOVË
PASQYRAT FINANCIARE

Shënimet e pasqyrave financiare më dhe për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2023
(Shumat në Euro, përveç nëse është specifikuar ndryshe)

6. MENAXHIMI I RREZIKUT FINANCIAR (VAZHDIM)

(a) Rreziku kreditor (vazhdim)

Kreditë dhe avanset për klientët janë me norma fikse dhe variable të interesit

Humbja në vlerë e kredive dhe letrave me vlerë

Humbja e vlerës së kredive dhe letrave me vlerë bëhet për kreditë dhe letra me vlerë për të cilat Banka konstaton se ka një probabilitet që nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjithë principalin dhe interesin e duhur sipas kushteve kontraktuale të kredisë / instrumentit

Kreditë në vonesë për të cilat nuk llogaritet humbje vlere

Huatë dhe letrat me vlerë, ku interesi kontraktual ose pagesa e principalit janë të vonuara, por Banka beson se zhvlerësimi nuk është i përshtatshëm në bazë të nivelit të sigurisë/kolateralit në dispozicion dhe ose fazës së mbledhjes së shumave që i detyrohen Bankës.

Lejimet për humbjet në vlerë

Banka krijon një provizion për humbjet nga zhvlerësimi që përfaqëson vlerësimin e saj për HPK dhe humbjet e shkaktuara në portofolin e saj të kredisë.

Kreditë dhe avanset për klientët, neto	31 dhjetor 2023	31 dhjetor 2022
As në vonesë e as të provizionuara	99,303,281	89,075,736
Në vonesë por jo të provizionuara	355,051	132,304
Në vonesë dhe të provizionuara	2,312,504	3,837,304
Gjithsej	101,970,836	93,045,344

Analiza e ekspozimit të rrezikut kreditor sipas ditëve në vonesë është më poshtë:

Kategoria (vjetërsia)	31 dhjetor 2023	31 dhjetor 2022
Standarde (0 ditë në vonesë)	99,380,170	89,841,146
Standarde (0-30 ditë në vonesë)	2,343,320	3,855,937
Vrojtuese (31-60 ditë në vonesë)	-	19,725
Nën Standard (61-90 ditë në vonesë)	10,203	45,663
Të dyshimta (91-180 ditë në vonesë)	192,150	-
Humbje (mbi 180 ditë në vonesë)	1,245,440	1,405,897
Interesi akrual	704,128	540,530
Minus: Tarifa e shtyrë e disbursimit	(51,129)	(136,273)
Gjithsej kredi në kosto të amortizuar, bruto	103,824,282	95,572,625
Minus: Provizionin për humbjet nga kreditë	(1,853,446)	(2,527,280)
Gjithsej kredi dhe avanseve për klientët, neto	101,970,837	93,045,345

Më poshtë është një analizë e kolateralit të marrë si mbulesë në lidhje me kreditë dhe paradhëniet për klientët:

Kreditë dhe avanset për klientët	Ekspozimi maksimal ndaj riskut kreditor	Gjithsej kolaterali	Kolateral i tepërt
31 dhjetor 2022	95,572,625	687,420,004	591,847,379
31 dhjetor 2023	103,824,282	295,151,830	191,327,548

Banka nuk është e lejuar që të shesë a po të lë peng prapë në kontrata kredie në mungesë të mospagesës nga pronari i kolateralit.

Ekspozimi neto për kolaterale përbëhet nga kolaterale për kreditë për një grup klientësh të miratuar në mënyrë qendrore, për të cilat kolaterali nuk mbahet në nivel lokal, por në nivelin e kompanisë mëmë.

Türkiye İş Bankası A.Ş.- DEGA NË KOSOVË
PASQYRAT FINANCIARE

Shënimet e pasqyrave financiare më dhe për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2023
(Shumat në Euro, përveç nëse është specifikuar ndryshe)

6. MENAXHIMI I RREZIKUT FINANCIAR (VAZHDIM)

(b) Koncentrimi

IS Banka ka një strategji kreditimi që përcakton llojet e investimeve (koncentrimet) duke u bazuar kryesisht në segmentet ekonomike siç janë industria, tregtia, ndërtimi, etj. Pasiqë Republika e Kosovës është e vogël, koncentrimi gjeografik brenda Kosovës nuk është i rëndësishëm; kjo strategji rishikohet dhe azhornohet në baza vjetore nga bordi i menaxhmentit apo banka.

Tabela e mëposhtme zbërthen ekspozimin kryesorë të bankës në vlerat e tyre neto, të kategorizuar në bazë të sektorit të industrisë së palëve.

Me 31 dhjetor 2023 dhe 2022, analiza e kredive për konsumatorë dhe bankave në bazë të sektorit të industrisë ishte si mëposhtë:

	31 dhjetor 2023	31 dhjetor 2022
Tregtia me shumicë dhe pakicë	43,948,012	45,575,134
Ndërtimtari	12,049,428	10,106,912
Prodhimi	30,531,655	30,490,341
Aktivitetet të patundshmërive	3,261,962	5,082,551
Aktivitetet e shëndetit dhe punës sociale	587,871	54,922
Shërbimet e ushqimit dhe akomodimit	548,498	2,019,585
Menaxhimi dhe shërbimet e ujit, furnizimit, kanalizimeve dhe mbeturinave	-	99,744
Individuale	191,402	383,983
Minierat dhe guroret	10,564,068	561,874
Shërbime të tjera	859,835	93,365
Transporti dhe Magazinimi	450,280	475,246
Shërbimet administrative dhe mbështetëse	-	3,572
Aktivitetet profesionale, shkencore dhe teknike	103,078	152,397
Informacioni dhe komunikimi	5,830	5,892
Aktivitetet financiare dhe te sigurimeve	-	18,684
Bujqësi, pylltari dhe peshkim	69,364	44,166
Interesi akrual	704,128	540,530
Tarifa e shtyrë e disbursimit	(51,129)	(136,273)
Gjithsej kredi me kosto të amortizuar, bruto	103,824,282	95,572,625
Minus: Provizionin për humbjet nga kreditë	(1,853,446)	(2,527,280)
Kredi dhe paradhënie për klientët, neto	101,970,837	93,045,344

Türkiye İş Bankası A.Ş.- DEGA NË KOSOVË
PASQYRAT FINANCIARE

Shënimet e pasqyrave financiare më dhe për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2023
(Shumat në Euro, përveç nëse është specifikuar ndryshe)

6. MENAXHIMI I RREZIKUT FINANCIAR (VAZHDIM)

(c) Rreziku i likuiditetit

Rreziku i likuiditetit është rreziku që Banka do të hasë vështirësi në përmbushjen e obligimeve të lidhura me detyrimet financiare që lidhen me dhënien e mjeteve monetare ose ndonjë pasurie tjetër financiare. Rreziku i likuiditetit mund të ndodhë si rezultat i financimit të pasurive afatgjata me burime afatshkurtëra. Kujdesi i Bankës është për të ruajtur konsistencën midis maturimit të pasurive dhe detyrimeve dhe strategjitë janë përdorur për të marrë fonde në terma më të gjatë.

Bazuar në parashikimet e rrjedhës së parasë, çmimet janë të diferencuara për maturime të ndryshme dhe si rrjedhojë janë marrë masat për të përmbushur kërkesat e likuiditetit; për më tepër vlerësohet likuiditeti që mund të jetë i nevojshëm për rrethana të jashtëzakonshme dhe përcaktohen burimet alternative të likuiditetit për shfrytëzime të mundshme.

Qëllimi i Menaxhimit të Rrezikut të Likuiditetit është të sigurojë sa më shumë që është e mundshme, që vazhdimisht do të ketë likuiditet të mjaftueshëm për të plotësuar detyrimet me kohë, në kushte normale dhe të pafavorshme, pa pësuar humbje të papranueshme apo të rrezikojë dëmtimin e reputacionit të Bankës. Menaxhimi i riskut të likuiditetit trajtohet në bashkëpunim dhe nën mbikëqyrjen e Departamentit të Grupit të Thesarit në Zyrën Qendrore. Më 31 dhjetor 2023 dhe 2022, pasuritë dhe detyrimet e Bankës kanë maturitet të mbetur, ndërsa maturimet e pritshme ndryshojnë nga ato kontraktuale si më poshtë:

31 dhjetor 2023	Deri në 1 muaj	1-3 muaj	3-12 muaj	1-5 vite	Mbi 5 vite	E pa specifikuar	Gjithsej
Pasuritë							
Paratë në dorë dhe në banka dhe gjendja me Bankën Qendrore	1,089,868	-	-	-	-	7,401,363	8,491,231
Investime në letra me vlerë	-	-	39,386	7,000,000	-	-	7,039,386
Depozitat me afat të caktuar në banka	1,249,425	-	-	-	-	-	1,249,425
Kreditë dhe paradhëniet për klientët	5,804,650	1,742,145	48,923,437	38,490,712	8,914,467	-	103,875,411
Gjithsej pasuritë	8,143,943	1,742,145	48,962,823	45,490,712	8,914,467	7,401,363	120,655,453
Detyrimet							
Detyrimet ndaj klientëve	17,876,528	6,469,716	30,386,383	29,204,174	-	-	83,936,801
Detyrimet ndaj bankave dhe Zyrës Qendrore	17,006,021	1,205,927	4,001,333	-	-	-	22,213,281
Detyrimet e qirasë	22,187	44,617	171,617	910,119	-	-	1,148,540
Detyrime tjera	455,191	-	-	-	-	-	455,191
Gjithsej detyrimet	35,359,927	7,720,260	34,559,333	30,114,293	-	-	107,753,813
Pozicioni neto	(27,215,984)	(5,978,115)	14,403,490	15,376,419	8,914,467	7,401,363	12,901,640
Pozicioni kumulativ neto	(27,215,984)	(33,194,099)	(18,790,609)	(3,414,190)	5,500,277	12,901,640	-

Hendeku ndërmjet pasurive dhe detyrimeve është duke u monitoruar në vazhdimësi nga Departamenti i Thesarit dhe Menaxhimit të Riskut të bankës. Ne kemi politika dhe procedura të brendshme me raporte të përcaktuara për të monitoruar hendek të ngjashme. Për më tepër, duke qenë se ne jemi degë e Isbank në Turqi (Selia Kryesore), e cila është një nga bankat më të mëdha në Turqi, dhe kjo u mundëson atyre që të mbështesin financiarisht Degën në Kosovë në çdo kohë të nevojshme dhe rrjedhimisht, kjo eliminon rrezikun e hendekut ndërmjet pasurive dhe detyrimeve.

Türkiye İş Bankası A.Ş.- DEGA NË KOSOVË
PASQYRAT FINANCIARE

Shënimet e pasqyrave financiare më dhe për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2023
(Shumat në Euro, përveç nëse është specifikuar ndryshe)

6. MENAXHIMI I RREZIKUT FINANCIAR (VAZHDIM)

(c) Rreziku i likuiditetit (vazhdim)

31 dhjetor 2022	Deri në 1 muaj	1-3 muaj	3-12 muaj	1-5 vite	Mbi 5 vite	E pa specifikuar	Gjithsej
Pasuritë							
Paratë në dorë dhe në banka dhe gjendja me Bankën Qendrore	14,363,482	-	-	-	-	13,890,870	28,254,352
Investime në letra me vlerë	-	-	99,770	-	-	-	99,770
Kreditë dhe paradhëniet për klientët	1,753,110	6,575,752	28,566,571	32,486,024	26,327,441	-	95,708,898
Gjithsej pasuritë	16,116,592	6,575,752	28,666,341	32,486,024	26,327,441	13,890,870	124,063,020
Detyrimet							
Detyrimet ndaj klientëve	21,540,528	5,033,903	29,159,680	34,680,300	-	-	90,414,411
Detyrimet ndaj bankave dhe Zyrës Qendrore	8,959,192	11,036,446	-	-	-	-	19,995,638
Detyrimet e qirasë	20,643	41,995	192,602	1,148,340			1,403,580
Detyrime tjera	613,474	-	-	-	-	-	613,474
Gjithsej detyrimet	31,133,837	16,112,344	29,352,282	35,828,640	-	-	112,427,103
Pozicioni neto	(15,017,245)	(9,536,592)	(685,941)	(3,342,616)	26,327,441	13,890,870	11,635,917
Pozicioni kumulativ neto	(15,017,245)	(24,553,837)	(25,239,778)	(28,582,394)	(2,254,953)	11,635,917	-

Türkiye İş Bankası A.Ş.- DEGA NË KOSOVË
PASQYRAT FINANCIARE

Shënimet e pasqyrave financiare më dhe për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2023

(Shumat në Euro, përveç nëse është specifikuar ndryshe)

6. MENAXHIMI I RREZIKUT FINANCIAR (VAZHDIM)

(d) Reziku i tregut

i. Rreziku i valutave të huaja

Ky rrezik vjen nga luhatjet e çmimeve të monedhës kundrejt monedhës funksionale, për bilancet që Banka mban në monedha të tjera. Departamenti i Menaxhimit të Riskut monitoron rregullisht këto kufizime të raportuara nga Departamenti i Thesarit dhe i raporton Bordit të Drejtorëve çdo luhatje të rëndësishme. Banka nuk parashikon ndonjë rrezik të rëndësishëm nga luhatjet e valutës së huaj, pasi ekspozimi i Bankës ndaj këtij rreziku është i parëndësishëm.

Sipas Rregullores për rrezikun valutor të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, kufiri prej $\leq 15\%$ të pozicionit neto të hapur valutor në çdo monedhë të huaj mbi kapitalin e nivelit 1 të Türkiye İş Bankası A.S. Dega në Kosovë është ruajtur dhe në fund të dhjetorit 2023 ishte 0.24%.

Për më tepër, kufiri prej $\leq 30\%$ i pozicionit total neto të hapur në valutë të huaj mbi kapitalin e nivelit 1 të Türkiye İş Bankası A.S. Dega në Kosovë ruhet dhe në fund të dhjetorit 2023 ishte 0.35%.

Tabelat e mëposhtme paraqesin shumën ekuivalente të aktiveve dhe detyrimeve financiare sipas monedhës më 31 dhjetor 2023 dhe 2022 të përkthyer në EUR:

2023	EUR	USD	Të tjera	Gjithsej
Pasuritë				
Paratë në dorë dhe në banka dhe gjendja me Bankën Qendrore	8,421,761	55,735	11,798	8,489,294
Depozitat me afat të caktuar në banka	-	1,242,791	-	1,242,791
Investimet në letra me vlerë	7,037,802	-	-	7,037,802
Kreditë dhe paradhëniet për klientët	101,970,836	-	-	101,970,836
Gjithsej pasuritë	117,430,399	1,298,526	11,798	118,740,723
Detyrimet				
Detyrimet ndaj klientëve	82,606,996	1,329,795	10	83,936,801
Detyrimet ndaj bankave dhe Zyrës Qendrore	22,213,281	-	-	22,213,281
Detyrime tjera	1,603,447	284	-	1,603,731
Gjithsej detyrimet	106,423,724	1,330,079	10	107,753,813
Pozicioni neto	11,006,675	(31,553)	11,788	10,986,910
Pozicioni kumulativ neto	11,006,675	10,975,122	10,986,910	-

Türkiye İş Bankası A.Ş.- DEGA NË KOSOVË
PASQYRAT FINANCIARE

Shënimet e pasqyrave financiare më dhe për vitin e mbylltur me 31 dhjetor 2023
(Shumat në Euro, përveç nëse është specifikuar ndryshe)

6. MENAXHIMI I RREZIKUT FINANCIAR (VAZHDIM)

(d) Reziku i tregut (vazhdim)

i. Rreziku i valutave të huaja (vazhdim)

2022	EUR	USD	Të tjera	Gjithsej
Pasuritë				
Paratë në dorë dhe në banka dhe gjendja me Bankën Qendrore	25,368,759	2,846,566	16,968	28,232,293
Investimet në letra me vlerë	99,770	-	-	99,770
Kreditë dhe paradhëniet për klientët	93,045,345	-	-	93,045,345
Gjithsej pasuritë	118,513,874	2,846,566	16,968	121,377,408
Detyrimet				
Detyrimet ndaj klientëve	89,062,143	1,352,256	12	90,414,411
Detyrimet ndaj bankave dhe Zyrës Qendrore	19,312,789	682,849	-	19,995,638
Detyrimet tjera	2,016,762	292	-	2,017,054
Gjithsej detyrimet	110,391,694	2,035,397	12	112,427,103
Pozicioni neto	8,122,180	811,169	16,956	8,950,305
Pozicioni kumulativ neto	8,122,180	8,933,349	8,950,305	-

ii. Rreziku i normës së interesit

Rreziku i normës së interesit është rreziku që vlera e një instrumenti financiar do të luhet për shkak të ndryshimeve në normat e interesit të tregut dhe rrezikut që maturimet e aktiveve me interes të ndryshojnë nga maturimet e detyrimeve me interes të përdorura për financimin e këtyre aktiveve (ri -rreziku i çmimit). Prandaj, kohëzgjatja për të cilën norma e interesit është fiksuar në një instrument financiar tregon se në çfarë mase ai është i ekspozuar ndaj rrezikut të normës së interesit. Pasuritë dhe depozitat me afat të klientëve të bankës kanë norma interesi fikse dhe të ndryshueshme, ndërsa huamarrjet janë me norma interesi të ndryshueshme. Normat e interesit të zbatueshme për pasuritë dhe detyrimet financiare janë shpalosur në shënimin përkatës të këtyre pasqyrave financiare. Politika e bankës për administrimin e rrezikut të normës së interesit përcakton mënyrën e identifikimit, matjes, ndjekjes dhe kontrollit të rrezikut në rast të modifikimit të normës së interesit. Banka është e ekspozuar ndaj rreziqeve të ndryshme që lidhen me efektet e luhatjeve të normave të interesit të tregut në pozicionin e saj financiar dhe flukset monetare. Qëllimi i Degës është të menaxhojë rrezikun e normës së interesit në një mënyrë të kujdesshme për të mbrojtur të ardhurat e Degës dhe kapitalin e aksionerëve nga dobësitë që rrjedhin nga luhatjet e normave të interesit. Qëllimi i Degës është të menaxhojë rrezikun e normës së interesit në një mënyrë të kujdesshme për të mbrojtur të ardhurat e Degës dhe kapitalin e aksionerëve nga dobësitë që rrjedhin nga luhatjet e normave të interesit. Departamenti i Departamentit të Thesarit monitoron dhe menaxhon aktivitetet ditore dhe raporton pozicionet aktuale tek Departamenti i Menaxhimit të Riskut dhe tek Menaxhmenti i Lartë i Degës.

Türkiye İş Bankası A.Ş.- DEGA NË KOSOVË
PASQYRAT FINANCIARE

Shënimet e pasqyrave financiare më dhe për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2023
(Shumat në Euro, përveç nëse është specifikuar ndryshe)

6. MENAXHIMI I RREZIKUT FINANCIAR (VAZHDIM)

(d) Rreziku i tregut (vazhdim)

iii. Rreziku i normës së interesit (vazhdim)

Departamenti i Menaxhimit të Riskut (DMR) do të monitorojë raportet e rrezikut të normës së interesit dhe do të këshillojë menaxhmentin e lartë të degës për menaxhimin e rrezikut të normës së interesit. Për shkak të një natyre me kompleksitet të ulët të Degës, matja është bërë nëpërmjet një metodologjie të thjeshtë duke aplikuar 200bps në një skenar stresi si në pozicionet e aktiveve ashtu edhe të detyrimeve. Këto rezultate raportohen nga DMR në baza tremujore në Zyrën Qendrore përmes linjave të raportimit.

Rreziku i akumuluar i normës së interesit që artikulon nivelin e pranueshëm të rrezikut të normës së interesit për Degën miratohet nga Bordi i Drejtorëve dhe rishikohet të paktën një herë në vit. Kufij të tillë janë përshtatur me madhësinë, kompleksitetin dhe përshtatshmërinë e kapitalit të Degës, si dhe aftësinë e saj për të matur dhe menaxhuar rreziqet e saj.

Tabelat e mëposhtme përmbledhin maturimin kontraktual të pozicionit neto të normës së interesit për aktivet dhe detyrimet financiare.

31 dhjetor 2023	Deri në 1 muaj	1-3 muaj	3-12 muaj	1-5 vite	Mbi 5 vite	Që nuk sjell interes	Gjithësej
Pasuritë							
Paratë në dorë dhe në banka dhe gjendja me Bankën Qendrore	8,002,623	-	-	-	-	486,671	8,489,294
Investimet në letra me vlerë	-	-	39,386	6,998,416	-	-	7,037,802
Depozitat me afat të caktuar në banka	1,242,791	-	-	-	-	-	1,242,791
Kreditë dhe paradhëniet për klientët – fikse	4,400,311	1,734,380	48,672,063	38,287,689	8,876,393	-	101,970,836
Gjithsej pasuritë	13,645,725	1,734,380	48,711,449	45,286,105	8,876,393	486,671	118,740,723
Detyrimet							
Detyrimet ndaj klientëve - fikse	3,884,616	6,469,716	30,386,383	29,204,174	-	13,991,912	83,936,801
Detyrimet ndaj bankave dhe Zyrës Qendrore - fikse	17,006,021	1,205,927	4,001,333	-	-	-	22,213,281
Detyrime tjera	477,379	44,617	171,617	910,118	-	-	1,603,731
Gjithsej detyrimet	21,368,016	7,720,260	34,559,333	30,114,292	-	13,991,912	107,753,813
Pozicioni neto	(7,722,291)	(5,985,880)	14,152,116	15,171,813	8,876,393	(13,505,241)	10,986,910
Pozicioni kumulativ neto	(7,722,291)	(13,708,171)	443,945	15,615,758	24,492,151	10,986,910	

Türkiye İş Bankası A.Ş.- DEGA NË KOSOVË
PASQYRAT FINANCIARE

Shënimet e pasqyrave financiare më dhe për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2023
(Shumat në Euro, përveç nëse është specifikuar ndryshe)

6. MENAXHIMI I RREZIKUT FINANCIAR (VAZHDIM)

(d) Rreziku i tregut (vazhdim)

iii. Rreziku i normës së interesit (vazhdim)

31 dhjetor 2022	Deri në 1 muaj	1-3 muaj	3-12 muaj	1-5 vite	Mbi 5 vite	Që nuk sjell interes	Gjithësej
Pasuritë							
Paratë në dorë dhe në banka dhe gjendja me Bankën Qendrore	22,395,406	-	-	-	-	5,836,887	28,232,293
Investimet në letra me vlerë	-	-	99,770		-	-	99,770
Kreditë dhe paradhëniet për klientët – fikse	1,753,110	6,575,752	28,566,571	32,486,024	26,327,442	-	95,708,899
